

## EQREM ÇABEJ

KARAKTERISTIKAT E HUAZIMEVE LATINE TË GJUHËS SHQIPE<sup>1</sup>

Huazimet latine të shqipes janë me rëndësi dyfishe për gjuhësinë. Gjurmuesin e kësaj gjuhe e vënë në gjendje që, duke u nisur prej pozitash të sigurta, të gjejë fijet që çojnë nga shkalla prehistorike në shkallën antike të saj, e njëkohësisht të ndjekë kalimin e saj prej fazës antike në fazën mesjetare. Romanistit i japin në dorë një mjet, me të cilin ai arrin jo vetëm të rrokë më me saktësi disa veçori të sistemit fonetik të latinishtes vulgare në shtrirjen e tyre gjeografike, po edhe të rindërtojë me një siguri më të madhe disa trajta dhe kupume nga të leksikut të saj.

Mjedisi gjeografik në të cilin u ushtrua ndikimi i latinishtes mbi shqipen, lloji edhe vazhdimi në kohë i këtij ndikimi, trashëgimia indo-evropiane-pararomake që vijoi të vepronte në strukturën gjuhësore të shqipes, lidhjet shumënduarsh të kësaj gjuhe me idiomat fqinje të Gadishullit ballkanik e të Gadishullit apenin, të gjitha këto, së bashku me veçoritë e truallit e të qarkullimit e me situatën politike e kish-tare, kanë shkaktuar që elementi latin mori tipare të veçanta në këtë trevë gjuhësore. Njëkohësisht, po për këto arsye, dhe për disa rrethana etnologjike, sociale e administrative të posaçme, ndikimit të latinishtes iu vunë këtu edhe disa caqe e kufi, përfundimi i të cilave qe ky, që të parët e shqiptarëve të sotëm nuk u romanizuan.

Po të duam të kemi një ide për shtrirjen dhe përmasat e këtij ndikimi gjuhësor në hapësirë e në kohë, gjendja paraqitet afërsisht si vijon. Në pikëpamje të hapësirës ky ndikim u ka ushtruar në një trevë në veri ose në të dyja anët të kufirit gjuhësor midis greqishtes e latinishtes në Gadishullin ballkanik. Sido që të mendojmë se ka kaluar kjo vijë kufiri me drejtim prej perëndimi në lindje, a më në veri a më në jug, një gjë mbetet e sigurtë: kjo vijë vështirë të caktohet me anë të mbishkrimeve, dhe s'mund të ketë pasur asgjëkund një vlerë absolute. Jo vetëm që — sikundër konstatoi Alexandru Philippide<sup>2</sup> — disa vende si Trakia Veriperëndimore dhe Dacia Mediterranea simbas dëshmisë së mbishkrimeve kanë qenë treva gjuhësisht të përziera, po edhe diçka tjetër do pasur parasysh këtu: Po të kish qenë ky Gadishull vetëm e vetëm i ndarë midis dy gjuhëve botërore të kohës antike, mbetet e pakuptueshme si fisi trakas i besëve ende në shekullin VI. të erës sonë ruante gjuhën e tij, dhe si ajo gjuhë që sot vazhdon të rrojë si gjuhë shqipe, i shpëtoi romanizimit. Prandaj ai kufi gjuhësor duhet të merret njëkohësisht edhe si kufi kulturar, në këtë vështrim, që në

1) Eotuar së pari gjermanisht në «Revue de linguistique» (Bukuresht), tome VII, 1962, Nr. 1, f. 161-199.

2) *Originia romînilor* I, f. 71 v. Tani së fundi H. Mihăescu, *Limba latină în provinciile dunărene ale imperului roman*, Ed. Acad. R.P.R., Bukuresht 1960, f. 37.

disa zona malore të vështira gjuhët e vendit u ruajtën më gjatë nëpër kohë.

Në situatën midis tipit të latinitetit kontinental, i cili përfaqësohet me rumanishten, dhe latinitetit bregdetar, që përfaqësohet me dalmatishten<sup>3</sup>, për elementin latin të shqipes del pyetja se cilës ndër këto dy treva do t'i caktohet. Kjo çështje, e cila është me rëndësi themelore për një karakterizim të leksikut me burim latin të kësaj gjuhe, mund të merret në shqyrtim vetëm në lidhje me një anë me marrëdhëniet e saj me dy idiomat romane lindore që u përmendën, më anë tjetër me problemin e trevës së banimit të shqiptarëve në Gadishull në kohët e lashta. Në lidhje me pikën e parë do thënë se rumanishtja me shqipen, me formën e tyre të sotmen, paraqiten më të afra ndërmjet tyre se secila nga këto gjuhë me dalmatishten, e cila shpeshherë duket të ndjekë rrugën e vet, sikundër tregon, ndër të tjera, mungesa, në lakim, e njëjës së mbrapme, tipar aq karakteristik për ato dy gjuhë. Një i tillë vështrim aprioristik i kësaj gjendjeje ndërkaq, për një kohë më të vjetër duhet kundërshtuar. Dalmatishten si sistem gjuhësor e njohim shumë pak, dhe ato që dimë prej saj, më e shumta janë rrenoja që na kanë mbetur. Përveç kësaj, duhet thënë se me ato që janë konstatuar aty gjer më sot, njohja e përkimeve të veçanta midis kësaj gjuhe edhe shqipes nuk është shteruar. Në këto kushte, një shqyrtim objektiv i materialit duhet të arrijë në këtë përfundim, që shqipja, në trajtimin e elementit të huazuar prej latinishtes, si gjeografikisht, ashtu edhe gjuhësisht zë një vend të ndërmjetëm midis rumanishtes dhe dalmatishtes. Në një përfundim të tillë çon tani edhe shqyrtimi i toponimisë historike në Shqipëri. Aty, një krahasim i emrave të vendeve të kohës antike, si *Scardus*, *Scodra*, *Lissus*, *Dyrrachium*, *Thyamis*, me përgjegjëset e tyre të sotmet, *Shar*, *Shkodër*, *Lesh*, *Durrës*, *Çam*— etj., tregon që zhvillimi ka shkuar kryekrejt në vijën e fonetikës së shqipes. Këto emra, në kundërshtim me mendimin që ka zotëruar gjer sot, vërtetojnë kështu kontinuitetin, vazhdimësinë e elementit shqiptar në këto anë, autoktoninë e tij së paku që prej epokës greko-romake<sup>4</sup>. Kështu pra treva gjuhësore e shqipes, që prej kohës së lashtë e këtej nuk ka pësuar ndonjë zhvendosje qenësore, dhe ç'humbi gjatë kohës pasromake, e fitoi më vonë përsëri në vijë të përgjithshme. Kur të vështrohen romanizmat e shqipes nga këto pikëpamje, arrihet prapë në përfundimin që ato kanë pjesë njëkohësisht dhe në latinitetin bregdetar-adriatik dhe në latinitetin ballkanik—të brendshëm e kontinental.

Një tjetër çështje është ajo se sa kohë ka zgjatur ndikimi gjuhësor i latinishtes. Duke u nisur nga disa konsiderata të përgjithshme, do të pranohet që ky ndikim — ndonëse jo aq intensivisht — filloi që në kohën para pushtimit të Ilirisë Jugore e të Epirit nga ana e romakëve, i cili u krye në shekullin II. para erës së re, dhe nuk pushoi kryekrejt me ardhjen e sllavëve. Kështu nuk shkelim në dërrasë të kalbët po të mendojmë që ndikimi latin ka zgjatur së paku shtatëqind vjet. Që brenda

3) Khs. sidomos Petar Skok, *Osnove romanske lingvistike I* (1940) 4 shën. 4, 42v.

4) Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkenca Shoqërore 2 (1958) 54 vv.

një periode kaq të gjatë, huazimet latine që hynin vazhdimisht në gjuhë, nuk kanë pësuar të njëjtin trajtim, kjo është një gjë që do të pranohet a priori; dhe kjo aq më shumë, kur të kihen parasysh përzjerjet etnike që janë kryer gjatë asaj periode. Këto arsyetime shpien vetvetiu në mendimin e një periodizimi të këtij materiali të huazuar. Po a mund të zbatohet një periodizim i tillë?

Le të këqyrim shkurtazi përpjekjet që ka bërë në këtë drejtim dija gjer më sot, kryesisht në sistemin fonetik. Gustav Meyeri vuri re se<sup>5</sup> huazimet latine që përmbajnë një velar, kanë hyrë shumë heret në gjuhën shqipe, ngase c-ja e tyre ë ka ruajtur vlerën e saj si gatural para një e-je dhe një i-je. Robert Helbigu mendon se lat. *cs* (*x*), në shqipen, në një periode më të hershme, në analogji me rumanishten, nëpër shkallën *ps* u zhvillua në *fsh* (*kofshë*), në një periode më të re në *sh* (*frashër*); sipas atij dijetari, vetëm huazimet që i përkasin shtresës më të parë (si *gjelbër gjel shelk qelq*, *pÿll* nga lat. *padulem*), iu shtruan metaforishtë së a-së në e dhe të u-së së gjatë në y, si edhe monoftongimit *au* në a (*aurum*: *ar*); gjithë huazimet më të vona (si *faj*, *kalë*, *mur*) kanë ruajtur a-në e u-në të pandryshuara, dhe *au*-në e ndryshuan në *av af* (*lavd*, *kafshë*)<sup>6</sup>. Sextil Pușcariu, në elementin latin të shqipes, kronologjikisht si dhe gjeografikisht dallon dy shkallë, dy faza huazimesh. Në të parën ai vendon ato fjalë, te të cilat, ashtu si në rumanishten, lat. *a* reflektohet me *a*, dhe lat. *u* e gjatë me *u*; në të dytën ato fjalë që a-në latine e reflektojnë me e dhe u-në latine me y, ashtu si në dalmatishten. Sipas mendimit të tij, shtresa e parë e fjalëve u muar që në atdheun e vjetër, në Daki, gjatë bashkëjetesës me të parët e rumunëve, shtresa e dytë i ka rrënjët te ndikimi dalmato-roman<sup>7</sup>. Gustav Weigandi, te labializimi i lat. *ct* në shqipen (*lucta*: *luftë*) gjen një shtresë më të moçme (*ct*: *pt*: *ft*), te zhvillimi *ct*: *ht*: *jt* (*directus*: *drejt*) një shtresë më të re<sup>8</sup>. Sipas Norbert Joklit, trajtat *zmojle* «djerr», *Groftat e Gojanit*, *Shkortull*, *Maja Volpul* të shqipes veriperëndimore, prej lat. vulgare *exmulgia*, *crupta* për *crypta*, *curtus*, *vulpes*, me o-në e tyre, që pajton me latinishten e provincës romake Dalmatia dhe që largohet nga reflektimi i zakonshëm i u-së së shkurtër të hapët në shqipen (e në rumanishten), në pikëpamje hapësirore, territoriale rrjedhin prej latinitetit të Prevalitanës, në pikëpamje kohore prej një periode (ende latine vulgare), në të cilën kombësia shqiptare, prej visesh më në lindje e në fqinjësi me të parët e rumunëve, u dyndën e erdhën në trevat e Adriatikut<sup>9</sup>. Afërsisht ashtu si Pușcariu dhe Jokli, edhe Henrik Bariçi<sup>10</sup>, duke përmbledhur mendimet e veta

5) *Nuova Antologia* 50 (1885) 592, *Gröbers Grundriss der romanischen Philologie* I, botim i parë, § 32.

6) *Die italienischen Elemente im Albanesischen*, X. *Jahresbericht des Instituts für Rumänische Sprache in Leipzig*, f. 20 v., 23, 43, 45.

7) *Beihefte zur Zeitschrift für Romanische Philologie* 26, 62 v. Khs. m'anë tjetër L. Spitzer, në *Mitteilungen des Rumänischen Instituts Wien* I 292 v.

8) *Balkan-Archiv* III 178 shën. 1.

9) *Balkan-Archiv* IV 196vv. Përmbledhje në *Indogermanisches Jahrbuch* XIV VII 145.

10) *O uzajamnim odnošima balkanskih jezika. I. Ilirskoromanska grupa* 4vv., *Hymje në historin e gjuhës shqipe* (1955) 62vv. Artikulli *Albanisch, Romanisch und Rumänisch* i këtij dijetari, botuar në *Godišnjak Libri I. Balkanološki Institut, Libri 1*, Sarajevë, 1957, f. 1-16, sikundër del dhe nga një recension që i bën E. Petroviçi (*Limba Română* X, 1960, 1, 79vv.), ndjek po të njëjtën ravë.

dhe të së tjerëve, në reflektimin dy llojesh të disa tingujve të latinishtes në shqipen, sheh një shtresim dhe gjeografikisht dhe kronologjikisht dyfish në romanizmat e kësaj gjuhe: reflekset lat. *ct*: shq. *ft*, lat. *x* (*cs*): shq. *fsh sh*, lat. *a*: shq. *a*, lat. *u* e shkurtër: shq. *u*, të cilat pajtojnë me rumanishten, pas mendimit të tij rrjedhin prej një shtrese gjuhësore më të vjetër e kontinentale, reflekset lat. *ct*: shq. *it*, lat. *x*: shq. *is*, lat. *a*: shq. *e*, lat. *u*: shq. *o*, lat. *u* e gjatë: shq. *y*, të cilat shkojnë me dalmatishten, sipas tij vijnë prej një shtrese gjuhësore më të re, që rrjedh nga kontaktet e shqiptarëve me romanët e bregdetit. Më në fund, edhe sipas Matteo Bartoliti, reflektimi labial i grupeve *gn* edhe *cs* në italishten jugore, në dalmatishten e në shqipen (shq. *luftë*, *kofshë*), është më i vjetër se reflektimi palatal (shq. *drejt*, *fryt*, *shenj*, *shtrenjt*). Risimi (inovacioni) palatal sipas tij ka hyrë aty prej Italisë Veriore, dhe grupet asimilatore (*nn*, *tt*, *ss*) kanë hyrë prej Italisë së mesme. Në vokalizëm, *y* nga një *u* e gjatë dhe *e* e *o* nga një *a*, sipas tij pas gjase rrjedhin prej substratit pararomak të Ilirisë<sup>11</sup>.

Le t'i shqyrtojmë shkurt këto teza, nga të cilat shumica, sikundër shihet, me kombinimin e faktorit hapësiror me faktorin kohor, paraqesin një farë lidhje në mes të tyre. Fakti që lat. *c* para një *e*-je dhe *i*-je u ka ruajtur në shqipen në trajtë të një guturali prepalatal (*cepa*: *qepë*, *cicer*: *qiqër*), i cili i detyrohet Gustav Meyerit, me formën e zgjeruar të një pajtimi të kësaj gjuhe me dialektin veljot të dalmatishtes dhe dialektin logudorez të sardishtes, ka hyrë në inventarin e qëndrueshëm të dijes gjuhësore<sup>12</sup>. Metafonia *a*: *e* përkundrazi nuk është e kushtëzuar kronologjikisht brenda periodes latine, po lidhet me disa procese të fleksionit të shqipes, si do të tregohet më poshtë; edhe ruajtja e *u*-së në forma të tilla si *mur* vërtet lidhet me një huazim më të vonë, po më fort me një huazim prej italishtes. Më vjen keq më anë tjetër që nuk mund të bashkohem me mendimin e Norbert Joklit në punën si gjykohet reflektimi i lat. *u* të shkurtër me *o* në shqipen në rasi të tilla si *zmojle*, mendim i miratuar nga ana e disa dijetarëve. Ky ndërrim fonetik i përket një zhvillimi të brendshëm të shqipes. Kemi të bëjmë me hapjen e *u*-së në *o* në gegërishten lindore, e cila sipas disa dëshmimeve shkrimore arrinte vise-vise gjer në det, duke rrokur dhe ndonjë anë të trevës së Mirditës, ku janë në përdorim *zmojle* me shumicën e rasave më *o* që u përmendën më sipër. Edhe *troftë* me *o*-në e saj mundet që hyn në këtë grup fjalësh. Mënyra e procedimit që ndjek Ernst Gamillschegu, duke kushtëzuar një dukuri të gjashme të rumanishtes (lat. *autumnus*: *toamnă*, lat. *muria*: *moare*) me labialin që gjindet pranë zanores, nuk mund të zbatohet edhe në fushë të shqipes, si vepron Günter Reichenkroni<sup>13</sup>. Këtu ky ndrim fonetik nuk është një ndrim i kushtëzuar, po

11) *Atti della Reale Accademia delle Scienze di Torino* LXXV (1939-40) f. 9 e botimit të veçantë, *Italia e Croazia*, 1942, 163.

12) Sipas Meyer-Lübkes (*Mitteilungen des Rum. Instituts Wien* I 32), elementi latin i shqipes në këtë pikë paraqet një shkallë gjuhësore më të moçme se cilado nga gjuhët romane.

13) *Südost-Forschungen* XIV 497.

një ndrim spontan; kështu shfaqet ndër të tjera edhe në *Shkortull*, ku shihet se nuk ka ndonjë labial. Vërtet se një emër si sllav. jugore *Skoplje* prej shq. *Shkupi* pas mendimit tim tregon se zhvillimi fonetik për të cilin bëhet fjalë këtu, është mjaft i vjetër në gegërishten lindore<sup>14</sup>. Megjithatë nuk mundemi një dukuri dialektore të shqipes ta marrim e ta ngjitim lart gjer në periodën e latinishtes ballkanike. Në lidhje më në fund me shtresimet që kanë menduar Pušcariu, Weigandi e Bariçi, është për të vërejtur që këto bazohen më hipotezën e pavërtetuar të një shtegtimi të shqiptarëve prej lindjes në perëndim. Aty pikësëpari për mendimin që zhvillimi labial i grupeve latine *ct cs* në gjuhën shqipe (*ct* në *ft*, *x* në *fsh*) të jetë më i vjetër se zhvillimi palatal (*ct* në *jt*; për *x*: *is* Bariçi nuk jep shembuj vërtetues), për këtë mendim nuk ekziston as hieja e një argumenti të vërtetë. Prej kësaj teze pra mund të qëndronte në fund të fundit pjesa hapësirore-gjuhësore si një mendim që meriton të merret në vështrim, mendim sipas të cilit shqipja, me mënyrën e trajtimit të këtyre grupeve konsonantike, nga një anë shkuaka bashkë me rumanishten, nga ana tjetër me dalmatishten. Ndërkaq edhe ky mendim është të paktën i njëanshëm, sepse fijet e marrëdhënieve nuk kalojnë aq thjesht nga sa mund të duket me vështrimin e parë. Nuk duhet harruar se rrethanat e dalmatishtes në lidhje me mënyrën e reflektimit të lat. *ct* edhe *cs* janë larg së qeni të prera e të qarta dhe me një trajtë të vetme; sidomos nuk mund të mohohen me siguri të plotë vazhdime labiale të këtyre grupeve; po të jetë që të vërtetoheshin këto, kjo gjuhë atëherë, me vazhdimet e dylojshme të lat. *ct* edhe *cs*, do të paraqitej shumë më e afër me shqipen. Një rezervë e tillë është me vend të bëhet edhe ndaj argumentit të ndrimt të *u-së* në *o* që u përmend më sipër; sepse mbishkrimeve të provincës romake Dalmatia me format e tyre *avoncolo*, *corret* etj. u qëndron përballë veljotishtja me format e saj *dulk* edhe *buka* prej lat. *dulce* e *bucca*, forma këto, me të cilat kjo idiomë shkon bashkë me rumanishten e me shqipen. Më në fund le të shqyrtohet shkurt edhe zhvillimi i zanoreve të tjera. Mendimi se përkimi i shqipes me dalmatishten në punë të metafonisë së *a-së* në *e* dhe të *u-së* së gjatë në *y* — përkim i vënë re qysh me Meyer-Lübken f. 30v. e 36 të punimit të cituar - përbëka një lidhje të vërtetë të këtyre dy gjuhëve, ky mendim ndesh në disa rrethana me peshë. Nuk është pasur parasysh sa duhet aty që këto zhvillime fonetike - ashtu si ndrimi *u:o* që u zu ngoje më sipër - paraqesin procese të brendshme të gjuhës, të cilat për një pjesë mund të rrokten me duar. Metafonia *a:æ*, sikundër u tha edhe më lart, është një ndrim i kushtëzuar kryesisht me fleksionin; ajo, tek emri, në njëjëset e tipit *shëndët*, *mbret*, sikundër kam treguar më një vend tjetër, u përftua më fort me rrugën e singularizimit të shumësit<sup>15</sup>. Që lat. *a* në gjuhën shqipe në fillim nuk u metafonizua, këtë ndër të tjera na e dëfton një njëjës i mirëfilltë si *shëndërtat* «e kreme e krishterë më 6 gusht, (dikur) e kremtja e Trinisë», që rrjedh prej lat. *sanctam trinitatem*. Sa të paqarta kanë qenë ndër-

14) Khs. vërejtjet tona në *Studii și cercetări lingvistice* X (1959) 4, 530.

15) *Lingua Posnaniensis* VIII 113vv., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 136vv.

kaq idetë që kishte Bariçi për kronologjinë e këtij ndrimi fonetik shihet edhe nga kjo, që ai këtë e bie të ardhur një herë prej dalmatishtes, një herë prej grupit trako-frigas, e një herë bile prej substratit mediteran (mesdhetar), që është edhe më i vjetër se ato<sup>16</sup>. Rrethana të ngjashme me të sipërmet duhet të paravendojmë (të presupozojmë) edhe për metafoninë *u:y* të shqipes, që kur u vërtetua nga ana e Norbert Joklit se shkalla fonetike e ndërmjeme aty ka qenë *ui* edhe në fazën gjuhësore më të renë<sup>17</sup>, gjë që e pat përsjatur më parë Meyer-Lübke<sup>18</sup>. Edhe sikur të mbetej jashtë ndonjë fjalë si *frujt* prej lat. *frūctus*, ku j reflekton guturalin, ashtu si te *drejt* nga *directus*,<sup>19</sup> ka prapsepapë fjalë si *ÿll*, te Gjon Buzuku (1555) *uill* (shkruar *ðill*), sot në ndonjë dialekt *uvill*, të cilat dëshmojnë për shfaqjen e vonë të këtij monoftongimi. Aty ndërkaq ka forma fjalësh me një *y* më të moçme, siç është *pÿll* prej lat. *padūlem*; prandaj këtu do të kemi parasysh praninë e dy shtresave, ose më saktë, të dy kategorive fjalësh. Duke shikuar këto të gjitha me një vështrim përmbledhës, do të themi se në lidhje me këto ndryshime zanoresh (*u:o*, *a:e*, *u* e gjatë: *y*), një afrim i shqipes me dalmatishten paraqitet mjaft problematik, dhe mendimi i një paralelizmi të rastit nuk është për të hedhur poshtë menjëherë. Për hir të metodës le të kihen parasysh në këtë mes fjalët që ka thënë Meyer-Lübke në lidhje me një tjetër çështje: «Në vend që të studjohet veljotishtja në tiparet vetjake të sajat, merren e zgjidhen sipas dëshirës disa dukuri të saj, të cilat gjinden edhe në ndonjë dialekt që ndodhet aty afër, dhe paraqiten ato sikur të ishin në gjendje të vërtetonin lidhje afrie, pa pasur shqyrtuar më parë mos është ky një përkim i rrejshëm, dhe kjo lidhje afrie e vërtetuar kështu, shtihet në punë përsëri për të vërtetuar më tej se zhvillimi paska qenë i njëlojtë në të dyja anët<sup>20</sup>. Po në qoftë se megjithatë do të pranojmë aty një lidhje afrie të tillë<sup>21</sup>, mbetemi sigurisht në një truall më të sigurtë po ta arsyetojmë atë më fort historikisht me afërsinë territoriale të këtyre dy gjuhëve gjatë mesjetës sesa ta çojmë te një bazë e lashtë e datës latine vulgare, bazë që nuk kapet *kurrikund* në këtë mes. Detyra e ballkanistit duhet të ishte kjo, që ai të tregojë «jo sa të gjashme gjuhët janë, po sa të gjashme erdhën e u bënë»<sup>22</sup>.

Duke nxjerrë një përmbyllje (konkluzion) nga këto vëzhgime, prej tingujve të ndryshëm vetëm *ke ki* mund të shfrytëzohet për një shtresim diakronik. Jashta fonetikës, ruajtja e neutrave të latinishtes në shqipen na dëfton një periudë më të vjetër huazimesh, në të cilën neutri ishte ende i gjallë në latinishten. Nga lëmi i leksikut, Gustav

16) *Hÿmje në historin e gjuhës shqipe* 63, 36, 58.

17) *Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen*, në *Festschrift der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg* 114v.

18) *Zeitschrift für romanische Philologie* 45, 642v.

19) *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkenca Shoqërore* 3 (1958) 80v.

20) *Mitteilungen des Rumänischen Instituts Wien* I 18v.

21) Kështu mendon Meyer-Lübke (në *vendin e cituar*, f. 36) në lidhje me përkimin e shqipes me dalmatishten në punë të zhvillimit *u* e gjatë në *y*, «përkim që nuk ka si të merrret si një dukuri gande e rastit», kurse Weigandi (*Balkan-Archiv* III 236) mendon se shqipja zhvillimin *u* e gjatë në *y* e kreu pa ndonjë ndikim të jashtëm dhe në një kohë të mëvonë.

22) H. Pedersen, në *Indogermanischer Anzeiger* 12, 93.

Meyeri (Fjalori etimologjik 95) vuri re që në gjuhën shqipe, ndër ditët e javës, e marta, e mërkura dhe e shtuna kanë emra latine, e diela me të hënën kanë emra që janë përkthime prej latinishtes, kurse emrat e së enjtes e të së premtes janë të errëta. Aty vihet re se shqipja tek emri i së dielës, e diel, ka ruajtur refleksin e emrit latin më të vjetër, *dies solis*, i cili i përgjigjet emrit ἡμέρα Ἡλίου të greqishtes, jo atë të (*dies*) *dominica*, që është formuar pas gr. κυριακή. Meqë ky emër kishtar i riu i kësaj dite të javës u shfaq në latinishten në shekullin IV të erës sonë<sup>23</sup>, kalku gjuhësor (përkthimi) i *dies solis* në shqipen është kryer para asaj kohe. Kjo gjë pajton me faktin që krishterimi u përhap heret në bregdetin ilir. Një huazim i vjetër është edhe fjala *qepë*, e cila rrjedh prej lat. *cepa*, që ruhet dhe në rumanishten, jo prej *cepulla*, e cila është më e re dhe vazhdon të jetojë në gjuhë të tjera<sup>24</sup>.

Po t'i sillemi tani shqyrtimit të çështjes së ç'vend zë dhe çfarë lidhje afrish ka elementi latin i shqipes në rrethin e gjuhëve romane, ky vend është i përcaktuar me këtë mënyrë, që ky element, sikundër dihet, së bashku me rumanishten, me dalmatishten dhe me elementet latine të serbokroatishtes e të greqishtes së re, bën pjesë në romanitetin lindor, vazhdim i latinishtes ballkanike. Ky grupim ndërkaq, ashtu si çdo afri gjuhësore, nuk përjashton kalime nga njëra fushë në tjetrën. Kështu p.sh. shqipja, krahas me këto afrime, paraqet dhe përkime (konkordanca) të veçanta me disa gjuhë e dialekte romane përndimorë më fort periferike, sidomos të Gadishullit apenin, duke formuar ajo, në pajtim me situatën gjeografike, gjer diku një halkë ndërlidhëse midis asaj treve gjuhësore dhe romanitetit lindor.

Veçoritë fonetike e leksikore të latinishtes ballkanike, që ne arrijmë më t'i nxjerrim me anë të një krahasimi të gjuhëve romane lindore ndërmjet tyre (e pjesërisht dhe me sardishten), siç janë ruajtja e *u*-së së shkurtër e të çelët si *u* (*furca*), pastaj fjalët *conventus*, \**cucūta* (në vend të *cicuta*), \**filianus*, *hospitium*, *manicare*, \**matteuca*, *mergere*, *pigitare*, *sanitatem*, *sanitosus*, dihen mirëfilli, prandaj nuk është nevoja të rimerren këtu. Vetëm do të shënohet se shqipja, me ruajtjen e disa fjalëve të terminologjisë kristiane, mban në këtë rreth një vend të veçantë, një rrethanë kjo që nuk është pa rëndësi për historinë e gjuhës kishtare latine dhe të përhapjes së saj në anët e Lindjes. Përveç masës së rasave të njohura si *adiunare*, *altare*, *angelus*, *balsamum*, *baptizare*, *benedicere*, *communicare*, *christianus*, *crucem*, *draco* (*dreq*), *dracōnem* (*drangua*), *ecclesia* *ecclisia*, *episcopus*, *evangelium*, *fallere*, *fallum* \**fallium*, *indulgēre*, *maledicere*, *miraculum*, *missa*, *monachus*, *oblata*, *paganus*, *pascha*, *peccatum*, *presbyter*, *quadragesima*, *rosalia*, *saeculum*, *sanctus*, *spes*, *spiritus*, *vigilia*, *virginem*, hyjnë këtu edhe disa fjalë që shumica paraqiten vetëm në gjuhën shqipe, si *castigare*, që pas mendimit tim ka dhënë ndëshkój, *Christi natale*: kërshëndelle, *famulus*: *famull*, *për* — † lat. *dolere*: përdëllėj «mëshiroj; shkoj për kryeshëndoshë» bashkë me emrin *dullye-ja* «dolor» (te Gjon Buzuku), *sanctam*

23) Khs. Kluge-Mitzka, Fjalori etimologjik i gjermanishtes, botim i 19, f. 717 te Sonntag.

24) Për raportin e ndërsjelltë kronologjik të këtyre dy formave khs. Carlo Battisti, *Avviamento allo studio del latino volgare* 70.

*trinitatem*: shëndertat «e kremte e krishterë më 6 gusht; (dikur) tri-  
nia», *tradere* që pas mendimit tim ka dhënë *truaj* «ia kushtoj; nëm,  
mallkoj hyjninë». Vetëm në shqipen ruhen në Ballkan më se një emër  
latin të djallit: *diabolus*, *draco*, *dracōnem* (për *djemën* shih më posh-  
të), pastaj edhe reflekset e *imperator* (*mbret*, *perëndi*) e të *imperato-  
rem* (*perënduar*, kjo mbase si një fjalë gjysmësavante), edhe ato të  
*regem* «mbret», terme të leksikut politik e kishtar, me të cilat kjo gju-  
hë merr pjesë dhe në leksikon roman lindor dhe në perëndimorin. Nga  
një shqyrtim historik i organizimit kishtar në Shqipëri rezulton që ky,  
në kohën e ardhjes së sllavëve, edhe si bashkësi (komunitet) fetare  
edhe në liturgjinë e tij e në gjuhën e saj, në qenësi, në esencë ishte  
tashmë i formuar. Vetëm me këtë rrethanë dhe me antagonizmin që  
zgjati gjithë mesjetën midis kishës perëndimore edhe lindores, gjen  
shpjegim fakti që në leksikon kishtar të shqipes të përbashkët për  
mbarë gjuhën nuk ka as edhe një huazim prej sllavishtes. Ky fakt,  
i cili është me rëndësi edhe për historinë e vendit, qëndron në kundër-  
shtim të shënueshëm me rumanishten, ku ndikimi sllav në gjuhën kish-  
tare dihet se zë një vend të dorës së parë. Në gjuhën shqipe terminolo-  
gjia kristiane me gurrë latine përbën shtresën më të moçme të gjuhës  
fetare, më e moçme se shtresa greke, dhe me përdorim edhe tek elemen-  
ti ortodoks i vendit.

Është një gjë e ditur se përbrenda romanitetit lindor shqipja më  
së forti afrohet me rumanishten. Dihet gjithashtu që diktimi edhe  
shpjegimi i përkimeve të pjesshme (parciale) midis këtyre dy gjuhëve  
paraqet disa vështirësi, sepse mbi të gjitha aty ndërthuren ngushtë  
elementet latine me elementet jolatine. Aty vetëm një gjurmim objek-  
tiv është në gjendje të dallojë gjer diku fijet që ndërliqen në atë mes  
dhe të ndjekë me një farë suksesi edhe çështjen e burimit në çdo rasë  
të veçantë. Për elementet jolatine në sistemin gramatikor (e fonetik) si  
edhe në leksik të së dy gjuhëvevet vetëm kjo do të thuhet që në krye, që  
shpjegimi i tyre me anën e substratit (nënshtresës) të përbashkët të një  
gjuhe ballkanike të lashtë, nga pikëpamja e rumanishtes në fund të  
fundit mund të jetë i pranueshëm, po nga pikëpamja e shqipes ndesh  
në vështirësi e dyshime metodike, sa kohë që koncepti i substratit është  
i kushtëzuar me një këmbim gjuhe, e një këmbim i tillë për shqipen  
pas gjendjes nuk ka si të pranohet<sup>25</sup>. Në pikëpamje pozitive kësaj i  
shtohet fakti, që ndër barazimet leksikore shqiptare-rumune me gurrë  
jolatine një pjesë e konsiderueshme ka farefisn e vet në shqipen ose  
gjen shpjegim gjithsesi me mjetet e kësaj gjuhe (*gälbeazä* - *gëlbazë*  
*këlbazë*: *kalb kalbem*; *gresie* «grihë» - *gërresë gresë* «vegël me të cilën  
gërryejnë: *gërryej* «kruaj; kruaj nga përbrenda»; *hameş* «lakmec, llu-  
pës — *hamës* «që ha shumë»: *hă*, ashtu si *pimës* «që pi, i pirë» (për  
shtjerrat etj.) nga *pî*; *strêpede* «krimb në djathë a në dhjamë të de-  
rrit» — *shtrep* «krimbi që zë djathë», e cila shkon me *shtërpîn* «emër  
që përmbledh gjithë shtazët që hiqen rrëshqanë» etj.). Gjithsesi për  
shqipen afëria me rumanishten i përket një periode që është shumë  
më e re se ajo nga e cila rrjedhin marrëdhëniet e shqipes me gjuhët  
motra indoevropiane. Përsa i përket elementit latin të së dy gjuhëvevet,

<sup>25</sup> Khs. vërejtjet tona në *Studii și cercetări lingvistice* X (1959), 4, f. 551, BUST  
SSS XVII, Nr. 3, f. 92.

i cili vetëm ky na intereson këtu, aty Meyer-Lübke<sup>26</sup> ka vënë në dukje, krahas me përkimet, me konkordancat, edhe ndryshimet që ekzistojnë midis dy gjuhëve. Ndikimi i latinishtes në Shqipëri, sikundër dihet, ka nisur tre shekuj më parë se në truall të Rumanisë. Dhe lidhjet me botën romane e me rrymat e saj kulturore kanë vazhduar në gjuhën shqipe edhe pas nguljes së sllavëve në Gadishullin ballkanik, nuk morën fund si ndodhi në Rumanë. Më anë tjetër ndërkaq, procesi i romanizimit ndër të parët e rumunëve të sotëm duhet të ketë qenë shumë më intensiv sesa ndër të parët e shqiptarëve, se ashtu shpjegohet formimi i një gjuhe romane në ato anë. Ashtu si në fushën e gjuhëve romane perëndimore, edhe në atë të gjuhëve romane lindore, një pjesë të konsiderueshme të leksikut latin popullor e kanë nxjerrë duke e rindërtuar nga gjendja e gjuhëve që janë sot të gjalla. Aty, për latinishtet ballkanik, përveç rumanishtes dhe dalmatishtes, vijnë në vështrim, sikundër dihet, edhe romanizmat e shqipes. Vetëm me anë të një krahasimi midis rumanishtes dhe shqipes arrihet të rindërtohen për latinishten vulgare, popullore disa trajta e kuptime fjalësh si \**curtiare* «shkurtoj», *falx* «nofull», \**filianus* «fijan» *galgulus* (në vend të *galbulus* «gargull»), *imperator*, \**incaballicare* (*incâlca* — *ngalkónj* «eci kaluar»), \**marrucinea* \**marrucina* («mërqinjë»), *mergere*, *mirari* «me admirue», *noverca* «njerjë», *pallium* «pajë», \**vescidus* «i ligur, i hajthëm», *virtutum* «forcë, fuqi». Vetëm të rumanishtes e të shqipes janë kuptimet *coma* «jele e kalit», *socius* edhe «i shoqi», *socia* «e shoqja», dhe *pacare* «me pajtue, me ujdisë». Vetëm për këto dy gjuhë do të pranohet një bazë latine *cónsocer* (rum. *cuscru* shq. *krushk*) përkundrejt bazës *consócer* të gjuhëve të tjera duke përfshirë aty dhe dalmatishten (P. Skok). I rumanishtes e i shqipes është në Ballkan asimilimi *m-l* në *m-n* në fjalën *similare* «me i përgja»: rum. *sămăna* «me i përgja» shq. *shemënjien* «shembëllen, përgjan; do të thotë» (P. Budi) përbri trajtës *shembëllën*. Përemri i pakufishëm (*n*)*donjë* i shqipes, fjalë për fjalë «do-një», është i formuar krejt ashtu si rum. *vreun*, *vreo*, që ka po atë kuptim, «ndokush, ndonjëri ndonjëra», prandaj kjo është *vrea-un*, *vrea-o*, e jo një lat.\**vereunus*. Me anë të kompozimit në ngërthim të fjalisë gjejnë shpjegimin e vet shq. (te Gjon Buzuku) *māse* «vetëm» (fjalë për fjalë «më se») dhe rum. *numai* «vetëm» (fjalë për fjalë «jo më shumë»), të cilat paraqesin një farë lidhje ndërmjet tyre në punë të formimit, e pikërisht në plotësimin e krahasimit përbrenda fjalisë mohore (*jo mā se... «jo më shumë se...», nu mai de (cît) «jo më shumë se...»*). Kështu del e qartë mënyra e formimit të së dyja ndajfoljeve, dhe shpjegimi i *numai* nga një lat. \**non magis* nuk është më i nevojshëm. Fjala *kumtër*, dikur *kümetrë*, *kómëtrë* «kumbarë» e shqipes siguron edhe për rum. *cumetru*, më e vjetër *cumättru*, një burim latin; dhe shq. *lukër* «dele; tufë dhensh», prej lat. *lucrum* «fitim, dobi, pasuri» (N. Jokl), me *koshëz* «Oestrus, insekt i rendit të dipterëve, që rron nën lëkurë të gjësë së gjallë», prej lat. *cosus* «krimb i drurit; krimb i zorrëve (V. Bogrea), bashkë edhe me rum. *lucru* «gjë, send, punë» dhe *çoş* «puçërr me qelb në fytyrë a në trup», vërtetojnë ekzistencën e këtyre fjalëve edhe në latinishten ballkanike. Një gjë e tillë do të pranohet tani edhe për rum. *codru* «pyll,

26) *Mitteilungen des Rumänischen Instituts Wien* I 41v.

mal» e për shq. *kodër*, kurqë për këtë të fundit dëshmohej tani edhe kuptimi «kënd, qoshe», te Buzuku e te Budi, *gūr n katër kodrësh* «angulari lapide» tek i pari. Shq. *mashkullorë* «jopjellore, për një tokë», që shkon me *mashkull*, ndihmon në interpretimin e rum. *bārbat* (në *deal barbat*, për një luginë), e cila pra është një me *bārbat* «mashkull», dhe jo refleksi i lat. *vervactum* «djerr, djerrinë, qersë», si mendonte G. Giuglea<sup>27</sup>. Edhe rum. *fire* «karakter, veti; mendje, arsye» *a-și veni în fire* «me ardhë në vete», *a-și eși din fire*, *a-și pierde firea* «e humb fillin, mendjen», mbi dëshminë e shq. *fill*, si shumësi i singularizuar *fije*, prej lat. *filum*: *me ardhë në fije*, *m'u vū për fije*, *e ka humbur fillin*, *i mirë për fije* e *i keq për dokë* «i mirë me zakone e i keq në të pamë»<sup>28</sup>, më nuk do ta afrojmë me foljen *fi* «me qenë, me ekzistue», po me *fir fire* «fill, fije». Për një të tillë zhvillim kuptimi khs. përdorimin metaforik të frgj. *fibre* «pejzë, është»: «prirje, veti shpirtërore», frgj. *veine* «dell; trill, prirje; fat», gjerm. *Ader* «dell»; «karakter; trill, prirje», *Faden* «fije», *den Faden verlieren* «me e humbë fijen (e bisedës)», *kein guter, trockener Faden ist an ihm* «asnjë veti të mirë nuk ka në të»<sup>29</sup>. Duhet vërejtur ndërkaq se në mbarë këtë fushë puna e rindërtimit, për shkak të dokumentimit të mangët, ndesh në vështirësi të mëdha. Dalmatishja është e dokumentuar në masë të pakët, shqipja e rumanishtja janë të dëshmuara vonë. Distanca kohore midis bazave latine të paravenduara (të supozuara) dhe formave reale të sotme të këtyre gjuhëve, që duhet të dëshmojnë për to, është bukur e madhe dhe nuk arrin të plotësohet me hallka të ndërjmeme, siç njihen në romanitetin perëndimor nëpërmes një tradite shkrimi të konsiderueshme, burimesh dokumentare, glosash e të tjerash mjete si këto. Në një truall kaq të pasigurtë, paplotësia e materialit mund të kompensohet gjer diku vetëm me zbatim të një sistematike të rreptë. Aty përkundrazi vërehet se nga përpjekja e natyrshe e romanistit për të nxjerrë sa më shumë fjalë prej latinishtes, gjuhësia ka shkuar nganjëherë tepër larg në pranim bazash latine. Etimologji të tilla si lat. \**aburare*: rum. *abura* shq. *avull*, \**alica*: *alcă alkë ajkë*, \**astrucare*: *astruca* *strukem*, \**balica*: *baligă balgë bajgë*, \**calvia*: *chelbe* *qelb*, \**deramare*/\**derimari*: *dărîma* *dërmój*, \**disvelare*: *se dezbara* *zbulój*, \**excubulare*: *scula* *shkul*, \**experlavare*: *spăla* *shp(ë)lāj*, \**extirpis*/\**extirpus*: *sterp* *shterpë*, \**farrimen*: *fărîmă* *thërime*, \**fragminare*: *fărîma* *thërmój*, \**fluctulare*: *flutura* *fluturój*, \**fossatum* ose *massatum*: *sat* *fshat*, \**grumulus*: arom. *grumur* shq. *grumbull*, \**inchoriare*: *incorda* *ngordh*, \**limacem*: arom. (a) *lumache* *lumāk* «vlastar, filiz, bulë, degë e gjelbër» *lumaq* «bulë a syth në drurë a në shkurre; degurina, muguj degësh», \**malitiare*: arom. *marifire* shq. *malcohem*, *malcohet* *plaga* «pezmatohet, mahitet», \**mandius*: *mînz* *mâz* *mëz*, \**negula*: *negură* *niëgull*, \**pica*: *pică* *pikë*, \**pitticus*: *petec* *petëk* *petk*, *ren* «veshkë»: *rinză* *rrënd* *rrëndës* «mullëz për të zënë djathë, rrâ», *sarica*: *sarcă* «zhgun i barinjve, me thekë» *shark* «zhgun leshi, i zi ose i bardhë, pa mëngë e me thekë, bërruc», *sella*: *șale* «kërbishtet, kryqëzat, ijët» *shalë* «ana e brendshme e kofshës; pjesa e trupit që shkon nga rrëza e kofshës gjer poshtë te

27) *Dacoromania* V 540. E papranuar te Meyer-Lübke REW 9264.

28) *Lingua Posnamiensis* VII 155. *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 21v.

29) Fjala greke *voûç* «mendje, arsye, vullnet», *νόημα* «mendim», si refleksi i një \**συλόφος*, mund të ketë lidhje me *νέω* «tjerr», *νήμα* «fill, tjerrë», *νήσις* «të tjerrët», *νεύρον* «dell i harkut, gjalmë, tel; nerv; fuqi».

syri i këmbës», *stringo: strungă shtrungë*, \**stulus: arom. stur shtyllë*, \**vertia: bîrsă bîrță* «veshëz e parmendës» *verzë verzë* «veshëz e parmendës, llapar», të tilla etimologji unë i gjej absolutisht të pamundura. Disa të tjera, si lat. \**amurca: rum. murg shq. murg* «i errët, i zi, i murrët», \**binati: arom. binaç shq. binjak*, \**broasca: broască breshkë*, \**capitina: căpățină kaptinë*, \**catteulla: căciulă kësulë*, \**excipitare: scăpată* «me perëndue, me mbarue» *shkupëtój* «dévancer», \**incunearre: încuia* «me ngujue» *ngujój* «mbyll brenda, blokoj», \**pistalia: păstaie* «gousse, cosse de haricot, de fève» *bishtajë*, \**sputire: stupi* «me pështy» *pështúj*, janë të paktën fort të dyshimta. Në barazime të tilla si *acris: acru* «i tharbët» *egër*, \**capitare: căpăta* «me marrë, me i dalë në krye» *kaptój* «dal tejmatanë, kaloj (malin); ia kaloj tjetrit; përcjell kafshatën, kapërdij», *cerebrum: creier* «tru» *krye*, *circus: cerc* «rreth, qark» *qark*, \**clagorium: chiag* «mullëz për të zënë djathë» *kluar* (shqipja e Greqisë) me të njëjtin kuptim, \**deexcitare: deștepta* «me sqe prej gjumi» *çoj*, \**directare: derepta* «drejttoj» (n) *dërtój*, \**excipitare: scăpăta* «me i dalë në krye» *kaptë*, *më të kaptë* «me të kapërcyer», \**flacula flaca: flacăra* «flakë» *flakë*, \**glanda: ghindă* «lende» *lende*, \**glemus glomus: ghiom* «lëms» *lëms*, *granum: griu* «grurë» *grunë*, *laceus laqus: lak* «lak», *lavare: laŭ* «laj» *laj*, *magis: mai* «më, mâ» *mâ*, *medius: miez* «mjedis, mes» *mes*, *mjes, mĕlum mĕlum: măr* «mollë» *mollë*, \**molliare: moiu* «zbus» *mul'va* (në Itali «e përkëdhela»), *murmurare: murmur* «murmurim» *murmurój*, *orma: urmă* «gjurmë» *gjurmë*, \**pedinus* «krehër i tezgjahut» *pedin* «fundi i paendur i një pëlhere, thekët» *pëjnë* «thekë», *per: pe* «për» *për*, \**pervigilare: priveghea* «me mbikëqyrë» *përgjój*, *petio: pețesc* «lyp për grua» *pyës*, *quid: ce* «çë» *çar çë ç'*, *radere: rad* «rruaj» *rruaj*, *ren* «veshkë» *rină* «ije» *rră* «mullëz për të zënë djathë», *sambucus: soc* «shtog» *shtog*, *scribere: scrie* «shkruaj» *shkruaj*, *secale: secară* «thekër» *thekër*, *sub(u)lum: sul* «shul i vegjve» *shul*, *taurus: taur* «dem» *tër* «dem», *vadium: vad* «va» *vă*, \**verrare: zbiera* «me britë» *vërrás vërrét* «thërret dhia» *virga: vargă* «thupër» *vërgár vargër* «dash a cjan (edhe kalë) i patredhur», pjesa e shqipes duhet të shlyhet. Në disa të tjera, si lat. *bubalus: rum. bour shq. buall*, *excutare: scoate* «nxjerr, qes, hedh» *shkund*, *haedus: ied* «keç, edh» *edh*, *horrere: uri* «me urrye» *urrëj*, \**invitiare: invăta* «me mësue» *mësój*, *versare: vărsa* «me derdhë» *vëshój*, ajo pjesë është e pasigurtë. Duke lënë mënjanë barazimet latino-rumune, çështjet që u shtjelluan këtu po i përmbledhim me këtë shënim, që rezultatet e arritura gjer më sot kryesisht me anë të rumanishtes dhe të elementeve latine të shqipes paraqitet nevoja t'i shtrohen një rishikimi, që kështu të mbërrijmë më në fund të kemi një ide të qartë për përmasat (dimensionet) e asaj që kuptohet me emrin latinitet ballkanik.

Rrethi i marrëdhënieve rumune-shqiptare merr një zgjerim me lidhjet që kanë këto gjuhë në punë të elementeve latine — dhe përtej caqeve të këtyre — me dialektet qendrore e sidomos jugore të italishtes. Këto lidhje, në gjurmimin e të cilave, që prej Franz Miklosichit e këtej, kanë pjesë një varg dijetarësh, përfshijnë, sikundër dihet, përveç leksikut edhe strukturën gramatikore, sintaksën, frazeologjinë dhe fjalëformimin. Detyra më e afër aty do të jetë kjo, që pas një mbledhjeje më të plotë të materialit dhe përshkrimit të tij, të jepet një shpjegim gjuhësor-historik i afrimeve që paraqiten në këtë fushë.

Midis dalmatishtes dhe elementit latin të shqipes, pas Meyer-Lübkes ka më shumë ndryshime se përkime. Largesia aty bëhet edhe më e madhe, po të heqim zhvillimin e njëlojtë në punë të metafonisë *a:e* dhe *u:y* si edhe ndrimin fonetik *u:o*, në pajtim me ç'u shtjellua më lart (f. 16 vv.) në lidhje me këto tipare. Megjithatë mbeten se mbeten disa përkime, të cilat shumica gjer më sot kanë qenë gjykarur gabim. Në fushë të fleksionit, në gjuhën shqipe femëroret e të ashtuquajturit lakim të tretë të latinishtes nuk e ruajnë, sikurse mendohet<sup>30</sup>, *e-në* e tyre fundore që rumanishtja e ruan, po e hedhin poshtë ashtu si në dalmatishten, pa u kthyer, në një periudë të parë, në mashkullore. Kështu p.sh. lat. *gentem, mortem, sanitatem*, sikundër e kam shtjelluar më me hollësi gjetiu<sup>31</sup>, në literaturën e vjetër, e në gjuhën popullore shpeshherë edhe sot, paraqiten me trajtat *gjind gjindja, mort mortja, shëndët shëndetja*, ashtu si dalm. *lau* «rremore, leranë» prej lat. *labem* «rrezim, rremore; njollë», përkundrejt rum. *ginte, moarte, sänätate*. Edhe në leksikon e dalmatishtes mund të gjindet ndonjë përkim me shqipen, po të studiohet sistematikisht, për këtë qëllim, në dëshmitë e tij dhe në mjetat (mbeturinat) që ka lënë në serbokroatishten. Vërtet se barazime të tilla si lat. *altare*: dalm. *oltar* shq. *ltër, calcem*: *klak këlqere, casulla*: *koşulja kësulë, centrum*: *kenra qendër, cimicem*: *kimak çimkë, laurus*: *lovor lār, lucerna*: *lukijerna luqerrë, missa*: *masa meshë, molinum*: *mllin mull, paganus*: *pogan pëgërë, persica*: *breskva pjeshkë*<sup>32</sup> gjinden më një anë edhe në gjuhët romane perëndimore, sidomos dhe në italishten, e më anë tjetër shumica edhe në rumanishten, po megjithatë, në lidhje me rrethanat që kemi përpara, prapë janë të tilla që duan pasur parasysh. Më me peshë janë disa përkime më specifike, sikundër janë serbokr. *pōlača* «pallat» shq. *pëllás* «pallat» prej lat. *palatium*, serbokr. *trakta tratka* «rjetë peshkimi, tratkë» shq. *trajkë* «rjetë peshkimi» nga *tractus*, serbokr. *kobla* «kubël» shq. *kubël kulbë*, kjo e fundit më fort prej një trajte ballkanike të lat. *clupea*, diçka si \**culba*, sesa prej sllavishtes<sup>33</sup>, serbokr. *râčun* «llogari, hesap, faturë», shq. *arsye* «shkak», dikur (Gj. Buzuku, Bardhi 148) «llogari» prej *rationem*, veljotisht (ishulli Velja në Dalmaci) *rasaun*. Kush kundron marrëdhëniet gjuhësore midis shqipes e rumanishtes dhe midis shqipes e dalmatishtes mbi një bazë historike, atij nuk ka për t'i shpëtuar një ndryshim qenësor (esencial) që ekziston ndër-mjet tyre: ato të parat në një kohë të caktuar u prenë, këto të dytat kanë vazhduar pa ndërprerje gjatë gjithë mesjetës. Më anë tjetër ato të parat, për arsye të ndryshme (gjasimi në mënyrë të jetesës, bashkë-jetesa, marrëdhëniet me rrugë tokësore), kanë qenë shumë më intensive se këto të dytat, të cilat kanë ndodhur kryesisht me rrugë detare.

30) Kështu sidomos G. Meyer, *Gröbers Grundriss I*, botim i parë, § 23; Meyer-Lübke po aty I, botim i dytë, f. 1042, 1048; N. Jokl IF 36, 148 vv., P. Skok, *Razprave Izd. Znatsvo Društvo za human. vede Ljubljani* 4 (1927) 21 shën. 8 = IJ XIII VII 169.

31) *Lingua Posnaniensis VIII* 13vv., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe 136vv.*

32) Khs. P. Skok, *Osnove romanske lingvistike I* 129v.

33) N. Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 92v., *Revue Internationale des Etudes Balkaniques II* 59; P. Skok, *Zeitschrift für romanische Philologie* 54, 425. — Për *kubël* vërejtjet tona te *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore* 1 (1958) 62.

Tipare të përbashkëta ndërmjet retoromanishtes dhe shqipes në lëmin e gjuhës kishtare latine nuk ka. Shq. *mëngjille mnjille* «darka para një të kremtje kishtare» nuk rrjedh prej lat. *mane vigil*, sikundër rrjedh *manval'* e Engadinit e *marveil* «në mëngjes heret» e valdensishtes së epër, në Zvicër; edhe *mungeshë murgeshë* nuk buron nga latinishtja vulgare si valdensishtja e epër *muniessa* dhe frgj. e vj. *moinesse*<sup>34</sup>. Për *mëngjille mnjille* duhet të kthehemi përsëri te mendimi i Gustav Meyerit, i cili e rrjedhjon prej lat. *vigilia*; sepse kjo fjalë tek autorët shqiptarë më të vjetrit paraqitet me formën *vëngjille*, me epentezë popullore të një *n-je*, të cilën e vuri re mirë H. Pedersen, dhe format *mëngjille mnjille* janë rezultati i disa proceseve asimilatore; *mungeshë murgeshë* është një rrjedhojë e brendshme e shqipes, nga *mung* (më e vjetër *munëg*, shumë *munëgj*) edhe *murg*, prej lat. *monachus*. Gjuha shqipe ndërkaq duhet thënë se me fjalën *taftár* merr pjesë në atë emërtim latin të fënerit, hinkës, i cili ka reflekset e veta ndër të tjera edhe në *trachuoir* të Engadimit e në disa forma të italishtes veriore (G. Meyer *Fj. et.* 421). Përveç kësaj, shqipja me retoromanishten kanë të përbashkët edhe një barazim që ka mbetur pa vënë re gjer sot: *kanushë* «lejlek»: engadin. *kanuos* «i thinjur, i drobitur», prej lat. *canōsus* «i thinjur» (kjo tek Ascoli, Meyer-Lübke REW 1610), me një zhvillim kuptimi si ai i shq. *bardhë*: rum. *barzā* «lejlek». Rumanishtja fjalës latine i përgjigjet me një trajtë të formuar me një tjetër sufiks: *cărunt* «i përhimë, i thinjur», prej lat. *canūtus*.

Ndër karakteristikat e huazimeve latine të shqipes hyjnë edhe marrëdhëniet e saj me sardishten, në të cilat shpeshherë, sikundër dihet, merr pjesë dhe rumanishtja. Aty, përveç dukurivët fonetike (reflektim i lat. *c* përpara *e-së* dhe *i-së* si *k*, ruajtja e *u-së* së shkurtër e të çelët), hyjnë edhe disa barazime leksikore, si lat. *certare*: sard. *celtare* shq. *qërtój* rum. *certa*; l. *linea*: s. *lindza* shq. *linjë* r. *lie* «këmishë grash»; *sanitosus*: s. *sanidosu* shq. *shëndoshë* r. *sānātos*; *vitricus*: s. *bidri gubirdiu* shq. *vitërk* «njerku» r. *vitreg*, fjala latine edhe në italishten e Kalabrisë; s. *moγoro* s. «kodër e vogël, kodrinë» shq. *magulë* «kodër, bregore», r. *māgurā* me të njëjtin kuptim. Këtyre duan shtuar dhe *oleastrum*: shq. *voshër* «Ligustrum vulgare» s. *ollastu* «ulli i egër, ullastër»; *pupa*: shq. *pupë* «një vesh rrush, vile rrush» s. *pupuyōne* «kokër rrush» shq. *rrotull* «rrotull druri a dheu që sillet rreth boshtit të vegjve dhe ndihmon në rrotullimin e tij» s. *loduru* me të njëjtin kuptim; shq. *shpátëzë* «pjesë e poshtme e parmendës» s. *ispado* po me këtë kuptim; *boboreshë* «mizë përdheske» s. *boborissina* i njëjti kuptim; shq. *karavúq* «Asphodelus ramosus, bimë» s. *tarabuk'k'ulu* i njëjti kuptim; shq. *zagár* s. *giagara* «qen gjoje, zagar», e ndonjë tjetër<sup>35</sup>; khs. dhe lat. *languēre, languor*: në Logudoro të Sardenjës *lambrire* «me pasë u, kam uri», *lambridu* në Nuoro *lāmbidu* «unshëm, i uritur», rum. *līngoare* «tifo», arom. meglen. *līngoare* «sëmundje», shq. *lëngjyer* «tifo», *lëngim* «të lënguarit; sëmundje; tifo», *lëngatë* «sëmundje e gjatë; epidemi ndër shtazë; sëmundë që u bie

34) N. Jokl IF 44, 27v., 39v.

35) S. Pușcariu, *Locul limbii române între limbile romanice*, Bukuresht 1920, 16 v., 45v.; M.L. Wagner, në *Germanish-romanische Monatschrift* VIII 51; Po ai, *Das ländliche Leben Sardiniens im Spiegel der Sprache* 17, 79, 126 shën 2, 142 shën.

pemëve<sup>36</sup>. Midis Shqipërisë dhe Sardenjës duhet të ketë edhe lidhje të moçme, e jo vetëm gjuhësore. Kështu p.sh. s'ka si të jetë një paralelizëm gand e i rastit që shërimi magjik i thumbimit që shkakton merimaga e verdhë, me mënyrën si përdorej gjer aty nga mesi i shekullit të kaluar në Shqipëri Jugore, gjen përgjegjësen e tij në Sardenjë. Sipas tregimit që na jep Johann Georg von Hahn<sup>37</sup>, atë që kish thumbuar merimaga, e vinin në një grumbull me pleh dhe thërrisnin e çonin tek ai nëntë gra që në mënyrë paronomastike kishin emrin Maro. Ato uleshin duke qerthulluar të sëmurin, këndonin së bashku një këngë (që jep ky autor në veprën e tij), dhe si kishin kënduar një copë herë, mendonin se i sëmuri shërohej. Ashtu edhe në Sassari të Sardenjës fëmijët që thumbonte merimaga e verdhë e quajtur *arza* (Tarantula Apuliae, *Latrodectus tredecimguttatus*), i vendonin në pleh, dhe atyre u këndonin shtatë gra të veja, shtatë të martuara dhe shtatë virgjëra, duke hedhur valle përreth tyre<sup>38</sup>.

Shqipja më në fund, shpeshherë së bashku me rumanishten, ka ruajtur disa fjalë e forma fjalësh të moçme, të cilat gjejnë përgjegjëset e tyre në iberoromanishten: shq. *ngushtë*, rum. *ingust*, span. port. *angosto*; shq. *bërsi* «fundërritë e rrushit, të ullinjeve e të kumbullave» (kjo jo prej lat. *brisa*), aragon., katal., valenc. *brisa* po me atë kuptim. Aty hyn dhe *kurrilë* *kojrilë* «emër shpendi, tojë», span. *grulla* bask. *kurruiño*, prej një lat. \**gruilla*. Pastaj edhe *furëqi* «fornicatio, luxuria, kurvëri» (Gj. Buzuku), prej lat. *fornix* + *i*: span. e Galicies *fornagar* «shkel kurorën», port. *fornezinho* «fëmijë jashtë kurore», logudor. e vj. (Sardenjë) *forrithu* «shkelje kurore» *forricare* «shkel kurorën», pa dyshim një përkim i shënueshëm në fushën e gjuhës popullore e kishtare<sup>39</sup>. E përbashkët për romanitetin ballkanik, italishten, sardishten e iberoromanishten është trajta latine *padülem* në vend të *palüdem*: rum. *pådure*, shq. *pyll pyllja* f. (kështu ende te Gj. Buzuku), it. (nëpër dialekte) *padule*, sard. *paule*, span. e vj. e port. *paül*. Për «agjëroj» romaniteti ballkanik me iberoromanishten kanë një bazë latine \**aiunare* në vend të *ieiunare*.

Duke i shikuar këto barazime në tërësinë e tyre, ato vërtetojnë në përgjithësi mendimin që zotëron për vendin që zë elementi latin i shqipës në rreth të gjuhëve romane. Për një afri të veçantë me gjuhët anësore, periferike, nga sistemi fonetik, përveç reflektseve *u* e shkurtër: *u*, edhe *ke ki*, që u përmendën më lart, dëshmon edhe reflektimi i diftongut latin *au* me anë të *a* dhe të *av af* (*ar, lavd, kafshë*), ku shqipja shkon bashkë me rumanishten, italishten jugore, sardishten e pjesërisht me provencalishten. Nga fusha e leksikut hyn këtu emërtimi i ditve të javës pa fjalën *dies* «ditë» (*e martë, e mërkurë*), ashtu si në rumanishten, veljetishten, retoromanishten, sardishten e spanishten. Fjala *kullana këllana* «dita e fundit e vitit, nata e motmotit të ri, bora e parë», e cila gjer më sot ka qenë gënjkuar gabim, së bashku me gr. e re *καλάνδα* «dita e

36) Po ai, në *Archivum Romanicum* XV 24, 42; N. Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 23 shën. 1, 210, 312.

37) *Albanesische Studien* I 157.

38) P.E. Guarniero, *Miscellanea linguistica Ascoli* (1901) 230.

39) *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore* 1 (1958) 68v. Khs. edhe Meyer-Lübke *REW* 3453; C. Battisti, *Avviamento allo studio del latino volgare* 72.

parë e çdo muaji» dhe me format retoromane e kelte (engad. *chalanda*, breton. *kalanna* etj.), pas mendimit tim reflekton jo lat. *calendae*, po trajtën *calandae*, e cila dokumentohet që prej kohës së Augustit<sup>40</sup>. Ndërkaq duhet shënuar së pari që jo gjithë përkimet e pjeshme (konkordancat parciale) çojnë peshë në punën e caktimit të vendit që zë elementin latin i shqipes në mjedis të gjuhëve romane; dhe së dyti, që shqipja ka një masë bukur të madhe huazimesh latine që janë me tipare romane të përgjithshme, e që bile për një pjesë përkojnë me disa gjuhë qendrore. Hyjnë aty fjalë si *ashkël* nga *assula* \**ascla*, *bukë* nga *bucca*, *dhurorj* nga *donare*, *farkë* nga *fabrica*, *fëmijë* nga *familia*, *fjalë* nga *fabella*, *fjeshtër thjeshtër* nga *filiaster*, *gaz* nga *gaudium*, *gram* nga *gramen*, *grigj* nga *gregem*, *gjind* nga *gentem*, *herë* nga *hōra*, *kafshë* nga *causa*, *këlqere* nga *calcaria*, *këmbë kambë* nga *camba gamba*, *kujtój* nga *cogitare*, *kunat* nga *cognatus*, *kurt* nga *cōrtem*, *martój* nga *maritare*, *mërzéj* nga *meridiare*, *mijë* nga *milia*, *ndijéj* nga *indulgēre*, *pëganë pëgërë* nga *paganus*, *pëllumb* nga *palumbus*, *përrallë* nga *parubula paraula*, *plagë* nga *plaga*, *pulqër* «gisht i madh i dorës» nga *pollicaris*, *pushtét* nga *potestatem*, *qepër* nga *capreus*, *sheke* nga *situla* \**sicla*, *shpatë* nga *spata*, *shpesh* nga *spissus*, *trajt* nga *tractus*, *verdhë* nga *viridis*, *vërtét* nga *veritatem*, *vnër vrër* nga *venenum*, *vullnét* nga *voluntatem*, *zanë zërë* nga *Diana*; aty edhe *kishë klishë* nga *ecclesia* (lat. e mesme, mesjetare *ecclesia*), duke munguar në shqipen *basilica* «kishë», që është e gjuhëve anësore, periferike. Këto izoglosa janë po me aq rëndësi për karakterizimin e huazimeve latine të shqipes sa edhe përkimet e pjeshme (konkordancat parciale) që u zunë ngoje më sipër. Ato njëkohësisht vërtetojnë që në këtë fushë afrish gjuhësore nuk ka kurrkund kufi të prera dhe që bashkë me tiparet dalluese shfaqen gjithkund edhe tiparet ndërlihdhëse.

Për të rrokur karakteristikat e leksikut të shqipes të huazuar prej latinishtes, me rëndësi themelore është edhe caktimi i vëllimit, i përmasave të tij.

Çështja se ç'është huazim latin në gjuhën shqipe dhe ç'nuk është, kjo çështje me çdo hap i del romanistit përpara. Këndej i del atij prandaj edhe një detyrë dyfishe, që më një anë të ndajë huazimet latine nga huazimet e tjera, më anë tjetër të veçojë në shqipen elementin huazim nga elementi trashëgim. Duke marrë në shqyrtim pikësëpari çështjen e parë, për kohën e fillimit të ndikimit latin, në lidhje me fjalët që kanë një pamje si latine, parimisht vjen në vështrim si gurrë edhe substrati paraindoevropian i zonës së Mesdheut, i cili, si për Greqi e për Itali, ashtu duhet të paravendohet edhe për pjesën veriore të Gadishullit ballkanik.

Për periodën e fundit të ndikesës së latinishtes, një veçim i kësaj shtrese nga shtresa e italishtes si një vijim organik i saj, nuk është e mundur të kryhet në çdo rasë me siguri. Megjithatë, në vijë paraprake do të pranohet që shumica e fjalëve prapsepapë u shtrohen kriterëve të dallimit, kështu që rrasat kritike e të dyshimta janë të paka. Kështu, në pikëpamje thjesht gjeografike, vihet re se huazimet latine shumica shtri-

40) Për format retoromane: C. Merlo, *I nomi romanzi delle stagioni e dei mesi* 183; për keltet: H. Pedersen, *Vergl. kelt. Grammatik* I 199. Khs. edhe Meyer-Lübken *REW* 1508.

hen mbi mbarë trevën gjuhësore të shqipës, ndërsa huazimet italiane shpeshherë kanë një përhapje me kufi dialektore. Në pikëpamje gjuhësore dallimi është i siguar që në pikënisje, në latinishten vetë. Kështu p.sh. fjala *këlqere* vjen prej lat. *calcaria*, *kërkój* prej *circare*, *pëlqej* prej *placere*. Ashtu qëndron puna edhe me *bukë*, *furkë*, *kupë*, *paq*, *peng*, *peshk*, *shigjetë*, *vjersh*, të cilat tregojnë qartë rrjedhën latine. Veçse krahas me këto ka një numër fjalësh, për të cilat në parim mund të përsjajet barabar një burim prej latinishtes ose prej italishtes, ngaqë format bazë latine e italiane që vijnë në vështrim në atë mes, nuk largohen shumë nga njëra-tjetra. Dija e gjertanishme këtu, duke përdorur një metodë të rreptë, shpeshherë shembëllore, në mënyrën si pasqyrohen këto fjalë në shqipen ka gjetur e caktuar kriteret e kufive të dallimit. Në vijë të përgjithshme vihet re se elementi latin, për punë të moshës më të madhe që ka, ka pësuar në gjuhën shqipe një ndryshim thuajse aq të madh në trajta sa edhe leksiku vendës i trashëguar dhe huazimet nga greqishtja e vjetër, me të cilat shpeshherë piqet në punë të vjetërsisë. Huazimet italiane përkundrazi nuk trajtohen shumë ndryshe nga huazimet prej sllavishtes e prej greqishtes së re, me të cilat ato marrin pjesë së bashku në zhvillimin e tingujve të shqipës gjatë mesjetës. Kështu p.sh., ndër karakteristikat e huazimeve latine, në fushë të vokalizmit hyn ndër të tjera zhdukja përgjithësisht e zanoreve të pathekse në ballë fjale dhe zhdukja e zanoreve të shkurtra të pathekse në fund fjale, reduktimi dhe shpesh edhe rënia e zanoreve të pathekse në trup fjale, metafohia e shpeshtë a : e, ndërrimi i u-së së gjatë në y, diftongimi i e-së së shkurtër të çelët në je dhe të grupit on në ua ue, nazalimi i zanoreve orale (gojore) +n; në konsonantizëm zhdukja e konsonanteve të zëshme në pozicion ndërzanor dhe lidhur me të edhe kontraksioni dhe zgjatimi i zanoreve fqinje, ndryshimi dhe reduktimi në shkallë të gjerë i grupeve konsonantike, asimilimi i dj-së, ndërrimi i s-së në sh dhe rregullimi i tingujve l ashtu si e caktoi Holger Pedersen. Në mbështesë të këtyre kriterëve, me të drejtë janë shpjeguar prej latinishtes të tilla fjalë si *bëkój*, *brekë*, *femën*, -ër, *frashën*, -ër, *frë*, *ger* «kitër», *qjeshër* «gjineshtër», *këmishë*, *këshill*, *korb*, *küt*, *li*, *mik*, *mjëk*, *mushkonjë*, *murtajë*, *pemë*, *pëndohem*, *pjergull*, *pjeshkë*, *prë*, *pushój*, *rem* «bakër», *rjetë*, *rrëshinë*, -rë, *sheke* «enë e drunjtë për djathë, qumësht etj.», *shenj*, *shenjt*, *shkallë*, *shpirt*, *shtat-i*, *tinë* *tirë* «kade e madhe që mbushet me verë», *thjeshtër* *fjeshtër*, *urdhën*, -ër<sup>41</sup>. Të tjera, si *apostull*, *balkue*, *callatë* «përkrenare», *i denjë*, *furtunë*, *kasolle*, *kore* «radhiqe», *kudhër*, *kushullë* «konsull», *lëvrój* «punoj arën», *magje*, *mandil*, *mostër*, *mur*, *pënik panik*, «Triticum panicum, lloj meli», *i qartë*, *rrugë*, *taverrë*, *urcuell* «vegsh», *verë*, *vel* «pëlhurë e anijes; cipë e hollë që mbulon fytyrën», *vesper*, *xhudhi* «çifut», i kanë shpjeguar me të drejtë prej italishtes. Për këto të njëjtat arsye, shpeshherë në kundërshtim me mendimin e gjertanishëm, në fjalë si *balshëm balçëm*, *çimkë*, *fë*, *fejój*, *ferr*, *grek*, *këndellë* «lambë», *shandan*, *këndellem knellem* «kuqem; ndizem, marr zjarr, digjem; përtërihem, marr fuqi, çelitem», *këprësh kopresh* «kapistër», *kurtinë* «perde», *lundër* «Mustela lutra, vidër», *regj* «mbret», unë jam i prirur të gjej

41) Për *frashër*, *rrëshirë*, *tirë* N. Jokl, në *Balkan-Archiv* IV 209 shën. 1.

huazime prej latinishtes; në disa të tjera, si *burdullák, kapua kapón* «gjel, kaposh», *kofën* «një farë thurime a trine e luguar që shërben për të zënë peshk», *trazój*, anoj të shoh huazime prej italishtes. Ndër emrat vetjake kristiane, *Pål, Ndre, Ndue, Gjon, Jozéf Zef, Mëri* rrjedhin prej lat. *Paulus, Andreas, Antonius, Johannes, Josephus, Maria*<sup>42</sup>. Edhe *Mërti Mërtir, Shtjefën*, në Toskëri Jugore (emër vendi) *Shqefër*, për arsye gjuhësore si dhe historike, do t'i çojmë te perioda latine e krishterimit në Shqipëri (*Martinus, Stephanus*). Një emër si *Pjetër* përkundrazi mund të jetë vazhdimi si i lat. *Petrus* si i it. *Pietro*, dhe vetëm për hir të rrethanave të përgjithshme historike do t'i caktohet latinishtes. Ky është një shembull që tregon se shpeshherë mungon një pikëmbështetje gjuhësore pozitive për përndarjen e huazimeve në këtë apo në atë krah. Për disa fjalë si *çmoj, durój, fajkua, i fortë, grep, kordhëz* «delli që shërben për të ngrehur harkun e për të hedhur shigjetën; zorrë e mëlçi të grira, të pjekura në shish, kukurec», *kulár, lardh* «shtresë e trashë dhjami, midis lëkurës e mishit të dërrit», *lëshój, limë, maj* «çekan i madh i farkëtarëve; tokmak i drunjtë e i trashë i samarxhinjve», *ngarkój, popull, rregull, tërfojë, tjegull, vapë*, çështja e burimit më të saktë është e diskutueshme. Këtyre u shtohen dhe disa rasa të tjera, si *fëniestrë, gremb* «prehër», *gresë* «rrush i papjekur, grezdë», *këmallë kërnallë* «kanal» përballë më të riut *kanál, korp* «trup», *shqopë*. Fjalë të tilla si *arkë, armë, durój, fik-u, hark, kunj, larg, letër, portë, rrotë*, e disa të tjera, si *barkë, formë, kartë, libër, shkollë*, nga ana gjuhësore mund të jenë barabar latine ose italiane, dhe kur të parat i janë caktuar latinishtes, e këto të fundit italishtes, aty kanë çuar peshë pa tjetër disa arsye kultur-historike ose të tjera. E dykuptimshme në punë të burimit është edhe *kurtjël* «thikë», bashkë me *kurtjellë* «lloj shpate e shkurtër e e drejtë», që është e afër me të e me *kërqelë* «thikë brezi». Sikundër shihet nga këto vërejtje, çështja se ç'është latine në shqipen e ç'është italiane, një nga çështjet parimore të gjuhësisë shqiptare, edhe pas punimit të njohur të Robert Helbigut (1903), nga shumë pikëpamje do të shikohet si ende e pazgjidhur gjer më sot. Në zgjidhjen e saj mund të ndihmonte vetëm një trajtim monografik i lëndës, ku përveç pikëpamjeve thjesht gjuhësore t'u jepej fjala edhe pikëpamjeve historike. Aty do pasur parasysh se me marrëdhëniet e Shqipërisë me Itali, të cilat rrjedhin prej afërsisë gjeografike, ndikimi gjuhësor i ardhur nga ajo anë, ka vijuar edhe pas mbarimit të sundimit romak. Në këtë rrymë huazimesh dallimi i dy shtresave është aq më vështirë të kryhet, kur të kemi parasysh që, sikundër dihet, caqet midis fazës së sprasme të latinishtes dhe fazës së parë të italishtes nuk janë të prera. Kështu pra, nga pikëpamja e shqipes kjo çështje shpeshherë bëhet një çështje kronologjike të thjeshtë, dhe mënyra e procedimit që do të zbatohet aty, është e krahasueshme me atë që ndiqet në punë të huazimeve prej greqishtes së vjetër dhe prej së resë. Duhet të kujtojmë aty që të njëjtat fjalë arritën në brigjet lindore të Adriatikut një herë me trajtë latine, e më vonë përsëri edhe me trajtë italiane. Me këtë proces dyfish të huazimit, me kohë u përfatuan edhe forma dyfishë, si *arsye* prej lat. *rationem* e *racëónj* «bisedoj» prej it. *ragionare* ven. *razonar, balshëm* e *balsám, dam dëm* e *dënoj, kuvënd*

42) Khs. edhe R. Helbigun, Die italienischen Elemente im Albanesischen (1903) 104.

e *konvënéj* «kam marrëdhënie, vemi e vijnë; piqem, merrem vesh», *lëti* e *latin*, *myll* e *mulë* «mushkë», *ndëshkôj* e *kastigôj*, *qerre* e *karro*, *shëkrôj* e *konsakrôj*, *shëlboj* «shpëtoj» e *salvôj*, *shkamb* «fron, stol, karrigë e skanjo «karrigë». Disa fjalë të tjera shtegtuhan kësaj në rrjedhë të pakëputur, me përfundimin që, nëpërmjet zëvendësimit të fjalës bazë latine me fjalën përkatëse të italishtes, kjo e fundit pjesërisht ndihmoi në ruajtjen e asaj së parës, e pjesërisht ndikoi në formën e saj. Kështu gjen shpjegim ruajtja ose restitucioni, rikthesa — përndryshe jo e zakonshme — e zanores së pathekse në ballë fjale ose në rrokje para theksit, ruajtja e *g*-së dhe *dj*-së ndërzanore si dhe *l*-ja e jashtërrregullt, në fjalë të tilla si *djall*, *Illiu*, *kështjell*, *parriz*, *pëgërë*, *plagë*, *ushinj*, *yndyrë*. Ashtu shpërgohen edhe *dishipull* e *dishepull*, *herë* edhe *horë*, ku u përziee lut. *hora* me it. *ora*. Të tilla fjalë mund të merren si huazime latino-italiane, poashtu si *arkë*, *armë*, *i fortë*, *letër* etj. që u përmendën më sipër, dhe si sufiksi *-aje* në fjalë si *grunaje* shm., i cili reflekton lat. *-alia* ose it. *-aglia*<sup>43</sup>. Ato tregojnë që çështja e burimit të tyre të mirëfilltë është me vlerë relative.

Një pikë që në punë të latinizimeve të shqipes nuk ka tërhequr vëmendjen e duhur gjer më sot, është ekzistenca e huazimeve librora (savante) përbri huazimeve popullore, e cila shpjegon edhe disa trajta që duken sikur nuk pajtojnë me ligjet fonetike. Përveç çifteve *farkë*: *fabrikë* (khs. frgj. *forge* e *fabrique*), *fytyrë*: *faturë*, *kallënduer*: *kalendër*, *ltër*: *altër*, në të cilat fjala e dytë është më e re, aty hyjnë disa huazime mjaft të vjetra, si *adhërôj*, *anatemë*, *aromë* (shumës *arómata*), *doktuor*, *gjendëni* «impietas» (që shkon me *gjind*, pas lat. *gentilis* «pagan»), *idól*, *kreatyrë*, *mákullë* «njollë», *mëkát murtár*, *pistull* «letër që i shkruhet dikuj», *tempull*, *unguënt*, në përhapjen e të cilave kisha ka pasur pjesën kryesore; khs. edhe *áuster* «erë e jugut» pranë popullores *ostër*, që rrjedh prej italishtes. E latinishtes kishtare është edhe *fiján* «famull, fëmija që mbahet në pagëzim», e pas gjase edhe *kuvënd* me kuptimin «manastir». Tek autorët e Veriut katolik, që dinin latinisht, gjejmë edhe kalke, përkthime, si të *mbétunatë* «banesat», pas *mansio*, *-onis* (frgj. *maison*), *përrállësitë* pas *fabulatores* te Gj. Buzuku, *hëza* «çadra» pas *umbrella* te Fjalori i F. Bardhit, që është i vitit 1635.

Një tjetër burim, gati krejt i lënë pas dore, është latinishtja e mesme, mesjetare. Prej asaj gjan të rrjedhin forma si *florí* (*florinus*), *gros* (*denarius grossus*), *kapë* «mantel», *kënatë* «enë dheu për ujë, shtamë; ibrik druri» (*cannata*), *kishë* (*ecclesia* në vend të *ecclesia*), *kultër* «jastëk» (*cultrum* në vend të *culcita*), *pakë* «secila nga dy pjesët me dhjamë që dalin prej kurritzë e prej barkut të dërrit të therur» (gjermanik. perëndimore *bakko* «përshtutë», kjo te Meyer-Lübke REW 889). Ashtu edhe fjala *kapetanjë-a* «kapedan» (të Gj. Buzuku) mund të lidhet po aq me lat. *capitaneus*, që del shpesh nëpër dokumentet mesjetare të Shqipërisë, sa edhe me it. e vj. *capitano*, venec. e vj. *capitagno* (khs. për këto Meyer-Lübken REW 1633)<sup>44</sup>. Edhe fjala *taftár* «fëner, hinkë» që u përmend më sipër, duhet të vihet në lidhje me lat. mesjetare *tractarius* (në vend të *traictorius*, Kluge-Mitzka<sup>49</sup> 790), e cila rron dhe në gjerm.

43) Khs. *Lingua Posnaniensis* VIII 76v., *Shumësi* i singularizuar në gjuhën shqipe 87.  
44) *Lingua Posnaniensis* VIII 74v., *Shumësi* i singularizuar në gjuhën shqipe 85.

*Trichter* gjerm. e lartë e vj. *trahtári*, breton. *treser* me të njëjtin kuptim<sup>45</sup>.

Kritereve fonetike që shërbejnë për veçimin e elementeve latine të shqipes, nganjëherë u bien ndesh disa faktorë të tjerë. Kështu p.sh. reflektimi i *s*-së me *sh* përgjithësisht çon te latinishtja, po ka mundësi t'i përkasë dhe dialektit venecian të italishtes<sup>46</sup>, në fjalë si *shtampë* «shtyp», *shtampój* «shtyp (një shkrim)», *shkollë*, *kushullë* «konsull», e në parim edhe italishtes së vjetër. Shihet kështu sesi faktorë të ndryshëm historikë e gjeografikë të gjuhës veprojnë krahas e kundra njëri-tjetrit dhe e bëjnë kështu mjaft të ndërlikuar çështjen e përkatësisë në njërën fushë a në tjetrën.

Ndër të tjerat gjuhë bija të latinishtes, në këtë pikëpamje vijnë në vështrim për shqipen dalmatishtja, e sidomos rumanishtja (me aromunishten). Që prej Meyer-Lubkes (*vendi i cituar*, f. 30v) e këtej mendohet shpeshherë për një ndikim të dalmatishtes mbi shqipen në lëmin e terminologjisë kishtare, në fjalë të tilla si *priift dalm. prievto*, *këngë*, *fiján* «famulli, fëmija që mbahet në pagëzim», *nun e kumtër* «kumbarë», *pagëzój*, ku sipas N. Jokli<sup>47</sup> bëjnë pjesë edhe *këmbonë* (bashkë me *mahajër* «djerrinë»). Kjo çështje kërkon një shqyrtim të ri në veçanti, aq më shumë kur fjalët bazë të dalmatishtes që parvendohen në atë mes, në pjesën më të madhe nuk janë të dëshmuara (*nun* sipas Gustav Mayerit f. 312 mund të rrjedhë prej greqishtes së re). Kundra burimit dalmat të disa formave metafonike si *mbret*, *ltër* «altar», *mrekull* jam shprehur në *Lingua Posnaniensis* VIIIv., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 134vv. Burimi i fjalës *çimkë* prej dalmatishtes, si mendon N. Jokli<sup>48</sup>, mua më vjen si i dyshimtë; kjo fjalë, ashtu si mendon alternativisht edhe R. Helbigu (f. 64), mund të rrjedhë drejtpërdrejt prej latinishtes<sup>49</sup>.

Përsa i përket rumanishtes, N. Jokli<sup>50</sup> te fjala baritore *lukër* «dele; tufë dhensh» pas gjase me të drejtë anon të shohë më fort një huazim prej latinishtes se prej asaj gjuhe; likuida palatale nistore e kësaj fjale na e përforcon më shumë këtë mendim. E njëjta gjë do të mendohet — bashkë me këtë dijetar e me të tjerë — edhe për *gjëndër gjandër*<sup>51</sup>, e cila prandaj nuk vjen as prej italishtes<sup>52</sup>, as prej rumanishtes<sup>53</sup>. Mendimi i George Pascut, që te fjalët e shqipes *bukllë* «brokë e drunjtë për të mbushur ujë, fllaskë, ploskë», *çok* «çekan; dorëz e portës, traku-llore», *flashë* «felë, copë; brez leshi a pambuku që e përdorin si dizgje»,

45) Kështu afërsisht dhe G. Meyer *Fjal. et.* 421; Puşçariu *Fjal. et.* 1757; Barić, *O uzajamnim odnosima balkanskih jezika* I f. 21.

46) Khs. K. Treimer, në *Mitteilungen des Rumänischen Instituts Wien* I 347v.; Jokl *IF* 36, 106 v.; C. Tagliavini, *L'albanese di Dalmazia* 33.

47) Litteris IV 197; Slavica XIII 287. Khs. edhe Kr. Sandfeldin *Linguistique balkanique* 61.

48) *Archivum Romanicum* XXIV f. 28v. e botimit të veçantë.

49) Khs. edhe *Buletin për Shkencat Shoqërore* 1 (1956) 127 shën. 2.

50) *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 257v.

51) Te Walde-Hofmann I 605; Helbig 120; M.E. Schmidt *KZ* 57, 22; Philippide, *Originea Rominiilor* II 643; E Çabej në *Revue Internationale des Etudes Balkaniques* II 172.

52) G. Meyer *Fjal. et.* 140; Meyer-Lübke, *Gröbers Grundriss* I<sup>2</sup> 1054.

53) P. Skok në *Archivum Romanicum* VIII 155; Barić, në *Arhiv za arbanasku starinu* II 414; Sandfeld, f. 64; Puşçariu, *Limba română* I 266.

*flamur, fluturój, milák* «këlysh lepur, kaçorr; fëmijë gjer më dy vjeç» paska një ndërmjetësi të rumanishtes, me gjithë miratimin që pati nga ana e N. Joklit<sup>54</sup>, nuk na duket medoemos i pranueshëm. Fjala *shpun* «dëftoj, çoj», të cilën gati përgjithësisht e bien të ardhur prej rum. *spun* «thom, flas» (kjo prej lat. *expono*), sikundër e ka vërtetuar C. Tagliavini<sup>55</sup>, nuk është gjë tjetër veçse *shpie shpura shpuna*. Fjala *bëtajë* «epilepsi; frikë, lemeri» nuk është e burimit rumun, po italian; *lemnj elemje elemine* «shtjelle, qerthull» është gr. *ἀνέμῃ* «enemi, qerthull», jo rum. *lemn* «dru». Për fjalën *pekúl* «mall, gjë, ndarë si pronë personale» burimi prej arom. *picul'u* «të holla që vihen mënjanë për pleqëri»<sup>56</sup> nuk më duket se shkon as nga ana e formës as nga e kuptimit (në përdorimin juridik), ndërsa një rrjedhë prej lat. *peculium* «pasuri e veçantë, më vete» nga ana kuptimore më duket se shkon shkëlqyeshëm, nga ana e formës përkundrazi jo aq mirë. Për *mel* «Panicum miliaceum» edhe *kukutë* «një bimë e helmtë, Cicuta virosa», çështja e burimit, a prej latinishtes a prej rumanishtes, gjer më sot nuk ka marrë një formë të prerë. Kundra një rrjedhe rumune të fjalëve *rutë* «Ruta graveolens, ryzë» edhe *brum* «brymë», prej të cilave kjo e dyta edhe si fjalë është krejt e dyshimtë, sillet me arsye të forta I. Şiadbei<sup>57</sup>. Te *koftór* «sobë për të gatuar, por» përkundrazi, një fjalë me përdorim të kufizuar dialektor, për punë të o-së që nuk u diftongua, më gjan të kemi më fort një huazim më të ri, prej rum. (ose arom.) *coptor* «furrë, stufë», me zëvendësim të grupit *pt* që është i vështirë për shqipen, sesa prej lat. ballkanike *coctorium*. Fjala e rumanishtes ka shkuar, si *koptor koftor*, edhe në bullgarishten. Për punë të ruajtjes së n-së ndërzanore, sikundër e vuri re i pari Gustav Meyeri<sup>58</sup>, edhe për *mënoj* «vonoj, qellem, bëhem vonë» vlen e njëjta gjë. Po për këtë arsye fonetike, si edhe për punë të u-së që nuk iu shtrua metaforishtë në *y*, edhe tosk. *kënut*, fem. *kënutë* «i përhimë, e përhimë, për skjep e për dhi» duhet të rrjedhohet prej arom. *cānut* «i përhimë» e jo prej lat. *canūtus* «i përhimë». Çështja nëse fjala *pllajë* «rrafshinë» që ngrihet mengadal nga fusha për në mal a në kodër; rrafshinë, fushë që shtrihet më një vend të lartë» vjen prej lat. mesjetare *plagia* «shpat» apo prej rum. *plai* «bjeshkë»; shteg nëpër një mal», një çështje që N. Jokli e la të hapët,<sup>59</sup> për arsye të karakterit velar të l-së duhet të marrë zgjidhje në të mirë të rumanishtes, sepse lat. *pl* në gjuhën shqipe ka dhënë *pl* (Pedersen KZ 33, 544), me *l* të zakonshme palatale, si në fjalën *plumb*; më pak vjen në vështirim një ndërmjetësi e greqishtes së re, të cilën e përsjati A. Philippide. Sipas P. Skokut<sup>60</sup> këtë fjalë e ka edhe serbokroatishtja, me trajtën *plai* e me kuptimin «fu-

54) *IJ* XI VII 190.

55) *Vendi i cituar*, f. 257v.

56) Puşcariu *Fj. et.* 1295; Capidan, *Dacoromania* VII 154; khs. vërejtet tona në *Buletin për Shkencat Shoqërore* 2 (1954) 48v.

57) *Revue Internationale des Etudes Balkaniques* III 460 dhe shën. 26.

58) *IF* 6, 105.

59) *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 174v. Në *IJ* XIV VII 169 ky dijetar amin në mendimin e një rrjedhe prej latinishtes vulgare. Ashtu edhe Walde-Hofmann II 314.

60) *Zeitschrift für romanische Philologie* 41, 152 e 756, nga sa po shoh te G. Pascu, *Rumänische Elemente in den Balkansprachen* 73.

shore e vogël rrëzë një mali». Një përkim midis rumanishtes dhe shqipes në sferën e jetës baritore, i cili i ka shpëtuar dijes gjer më sot, është barazimi rum. *sârciner sâlciner* «një hu me grremça ku barinjtë varin petkat, enët, napat me djathë për të kulluar etj.»: shq. geg. *shelqnu-r shelqnor*, tosk. *shelqërór*, -i m. «një dru si furkë, me tre-katër grremça, përpara kasolles së barinjve, ku këta varin napat e djathit dhe enët e bulmetit; furkë për të mbajtur hardhitë, krikull», *plori e shelqërori* «bujqësia e bagëtia». Sikundër shihet, pajtimi i dy fjalëve në punë të kuptimit është i plotë. Kjo gjë vlen edhe për trajtat e tyre, ngase që të dyja shihet se u janë mbështetur reflektive të lat. *salicem*, shq. *shelk*, rum. *salcie*, ose kanë kryer një disimilim *r-r* në *l-r*. Një ndryshim ka në sufiks të tyre: rum. *-er*, shq. *-uar -uer*, kjo nga *-or*, gjë që të kujton sufikset rum. *-ar*: shq. *-uar -uer*, në fjalët *armësariu*: *harmëshuar* «kalë i patredhur që mbahet për mbarë, hajger», *ciresar* «qershar»: *qershuer qershór* («muaj i qershive»), khs. edhe *kallënduer* prej lat. *calandae calandarius*, *kundruall* prej *contrarius*. Emrin e rumanishtes e kanë marrë si një formim të brendshëm nga rum. *sârcinâ* «barrë, ngarkesë, vandak». Një rrjedhë e fjalës së shqipes prej rumanishtes, për punë të formimit të ndryshëm që u përmend më sipër, ka pak gjasë që të jetë. Më afër mendsh është që të dyja fjalët të rrjedhin prej lat. *sarcinarius sarcinarium*, e cila është e dëshmuar që prej Cezarit e këtej, në shqipen ndërroi sufiks, e në rumanishten na paraqitet në trajtën e një shumësi metafonik e të singularizuar. Fjala latine rishfaqet edhe në dialektin kalabrez të italishtes, *saricinaru* «grossa trave del tetto, trave maestra<sup>61</sup>, duhet prandaj t'u shtohet atyre përkimeve që ekzistojnë midis romanitetit lindor dhe dialekteve italiane jugore. Nga fusha toponomastike le të përmendim këtu *Vajkâl*, më e vjetër *Valkâl*, te Marin Barleci (1537) *Valchalia*, emri i një lugine në krahinë të Dibrës, që përbën rrugë kalimi, të cilin e kam trajtuar gjetiu<sup>62</sup>. Ky emër, si «luginë udhë, luginë kalimi», mund të ketë ardhur prej lat. *vall(is) callis* «luginë rrugë» ose prej rum. *val(e)cale* po me këtë kuptim, veçse tani burimi rumun më vjen se ka më gjasë, për punë të *a-së* së pathekse të rrokjes së parë që ka mbetur e tillë, e pandryshuar. Atëherë ky emër do të bënte pjesë në ato gjurmë rumune në toponomastikën shqiptare që ka zbuluar N. Jokli me mprehtësinë që e shquan<sup>63</sup>. Si emërtes të *Vajkâl-it*, për arsye gjeografike, në radhë të parë vijnë në vështrim vllhtë mesjetarë të luginës së Drinit.

Në lidhje me elementet latine që i kanë të përbashkëta rumanishtja me shqipen, do të ishte me rëndësi të përsjatej jo vetëm mundësia ose domosdoshmëria që në elementet që ka shqipja të ketë qenë ndërmjetës rumanishtja, po edhe që në ato që ka rumanishtja (me aromunishten) të ketë pasur një ndërmjetësi nga ana e shqipes. Në këtë çështje, të cilën e kanë pasur parasysh dhe të tjerë dijetarë, këtu nuk mund të hyhet.

61) G. Rohlfs, *Dizionario dialettale delle tre Calabrie* I 218; G. Alessio, në *Annali della Facoltà di Lettere e Filosofia Bari* 1 (1954) 42.

62) *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore* (1958) 58 shën. 188, *Studime filologjike* XXI (IV) Nr. 2 f. 5.

63) *Zeitschrift für Ortsnamenforschung* X 197vv., *Studia albanica* 2, 1964, 75vv.

Pozita gjeografike e Shqipërisë përbrenda trevës së kulturës greko-romake në kohën antike, prania e ngulimeve greke e romake në këto anë, marrja e huazimeve greke e latine afërsisht në të njëjtën periudhë dhe në rrethana kulturore të barabarta, reflektimi i këtyre huazimeve në mënyrë të barabartë në gjuhën shqipe, e më në fund ekzistenca e huazimeve greke në latinishten dhe e huazimeve latine në greqishten, këto të gjitha bëjnë që për ndonjë fjalë nuk del në mënyrë të prerë se me ç'rrugë ka depërtuar në shqipen. Aty pikësëpari është puna të dallohet lënda leksikore që është marrë prej greqishtes së vjetër nga ajo që ka hyrë me rrugë të latinishtes; dhe anasjelltas të veçohen elementet që janë marrë drejtpërdrejt prej latinishtes nga ato që hynë me anë të greqishtes (së mesme ose të resë). Këto çështje gjër më sot nuk janë shikuar në tërësinë e lidhjen e tyre sistematike, megjithëse rëndësia që kanë i kalon edhe caqet e shqipes. Pa hyrë as këtu në hollësi, duhet para së gjithash të thuhet se sidomos që prej studimit të Albert Thumbit përmbi elementet greke të vjetrat të shqipes<sup>64</sup>, studim që çeli shtigje të reja, dihet tashmë mirëfilli që fjalë të tilla si *drapën -ër*, *fier*, *lakën -ër*, *liqén*, *mokën -ër*, *pjepën -ër*, *qershí*, *shpellë* rrjedhin drejtpërdrejt prej greqishtes së vjetër, nuk kanë hyrë me anë të latinishtes. Kështu qëndron puna tani edhe me fjalët *kumbull* dhe *mështekën -ër* «Betulla verrucosa, emër druri», të cilat prandaj reflektojnë gr. e vj. κοκκύλλων (v në greqishten veriperëndimore e dorishten = u) dhe μαστίχινος «rrëshinor» e jo ndonjë lat. \**columbula* e *masticinus*. Nga fusha e greqishtes së mesme (mesjetare) hyn këtu (sipas N. Joklit IF 44, 44vv.) fjala *matërgonë*, -orë «Mandragora officinalis; Hyoscyamus niger, bar i trashë», prej *μανδραγόρας* (jo prej lat. *mandragora*), e cila bashkë me *mështekën* ka shkuar dhe në rumanishten (*mătrăgună*, *mesteacăn*)<sup>65</sup>. Prej greqishtes së mesme ose të resë (*άπαλεριά*), jo prej një lat. \**pariolum*, ka ardhur dhe fjala *pararé* «pjatë e përfushtë». Përkundrejt këtyre formave ka disa të tjera, si *kallëm* «*kallm*», *maráj*, *sherp* «Apium graveolens, lloj i egër i selinos», *ypëshkv*, për gurrën më të saktë të të cilave (a drejtpërdrejt prej greqishtes apo nëpërmjet latinishtes) mendimet janë të ndara. E dykuptimshme (ambigüe) më duket në këtë vështrim edhe geg. jugore *qerm* «anë, buzë, qenar», sidomos *qermi* i *arës* (nga një *tjerm*), për të cilën vijmë në vështrim si gurrë barabar gr. *τέρμα* «cak, fund, mbarim; pushtet eporr», *τέρμων* «cak, kufi» dhe lat. *termen* *termō* «gur kufiri, kufi, fund, skanj», *terminus* «gur kufiri»; khs. rum. *țärm* «breg lumi, anë deti; vend, krahinë», të cilën e bien të ardhur prej lat. *terminus*. Një tjetër fjalë, edhe

64) IF 28 (1909) 1-20.

65) Khs. *Lingua Posnaniensis* VIII 91v., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 106v. Nga emrat vetjake kishtare (emra shenjtorësh), N. Jokli (*Zeitschrift für Ortsnamenforschung* X 201; IF 44, 40v.: *Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen* 112vv.) emrat *Llezhdër*, *Qurk*, *Todër* të Veriut me të drejtë i çon te kjo periudhë e greqishtes (Ἀλέξανδρος, Κυρικός, Θεόδωρος). Këtyre duan shtuar tani edhe *Llesh*, prej Ἀλέξιος, e *Mathë-u* (te Gj. Buzuku e te Bardhi) prej Μαθηαῖος, edhe këto me përdorim në Veri. Prandaj këto emra janë analogjia greke e emrave *Päl*, *Ndue* etj., që u përmendën më lart. *Llesh*, nëpër kompozita (*Gjollësha* = *Gjon Lleshë*), është edhe e Shqipërisë Jugore.

kjo mbetur e pavënëre gjer tani, është *kandër* «enë okatare për vaj, lyer me bojë përbrenda e përjashta», te Gj. Buzuku «Iecythus». Vjen prej gr. së vj. *κάνθαρος* «kupë me dy veshë, për të pirë» ose prej lat. *cantharus*, me burim prej greqishtes, një fjale që ka qenë popullore që në latinishten e Plautit dhe që vazhdon të jetojë në gjuhët romane<sup>66</sup>. Të dhënat e kulturës materiale do të dëshmonin për një huazim të hershëm, sepse kantare të punuara me dorë prej deltime të verdhë janë gjetur në Shqipëri veriore si prodhime minoike lokale që nga mbarimi i periodes së bronicit ose nga fillimi i periodes së hekurit<sup>67</sup>. Meqë *κάνθαρος* merret si fjalë paragreke<sup>68</sup>, *kandër* e shqipes mund të rrjedhë nga një huazim i kryer në një periode para greqishtes. Serbokr. *kondijer kondir* «bardak, kupë» Miklosichi (te Berneker I 558) e bie të ardhur prej lat. *cantharus*, po M. Vasmeri — a me të drejtë? — prej gr. së re *κροντήρι* «shtamë»<sup>69</sup>. D. Scheludko mendon si burim it. *cántero* «oturak, bokal»<sup>70</sup>, mendim që edhe ky nuk është më bindës. Fjala e serbokroatishtes ka hyrë në shqipen, si *kondir* m. «masë tri okësh për raki».

Përsa u përket fjalëve greke që kanë shkuar në latinishten dhe që si elemente leksikale greko-latine kanë qarkulluar nëpër Gadishullin ballkanik dhe në trevën e Adriatikut, aty ka një kriter për të gjetur rrugën nëpër të cilën depërtuan në gjuhën shqipe. Këtë kriter unë e gjej në theksin: më një anë në ndryshimin që ekziston në vendin e theksit në të njëjtat fjalë të dy gjuhëvet klasike, më anë tjetër në ruajtjen e rregullt të vendit të kryehershëm (origjinal) të theksit në huazimet greke e latine të shqipes — me gjithë ndonjë rrafshim analogjik që mund të ketë ndodhur aty. Kështu pra, mjafton vetëm kjo arsye — duke lënë mënjanë tiparet e tjera — për të vërtetuar që fjalët *qershí* edhe *ppjepën* që u përmendën më sipër, janë huazime prej gr. së vj. *κερασία* edhe *πέπων*, jo prej lat. *cerasum* e *pepōnem*. Dhe meqë vendi i theksit në fjalët e greqishtes dihet, e në fjalët e latinishtes mund të nxirret edhe më anën e dëshmisë së gjuhëve romane, fjalë të tilla si *bagëm* «vaji i bekuar që përdorej në ceremonitë fetare katolike; pagëzim», *djemën* shm. «daj, dreqër» duhet të jenë marrë pandërmjetësisht prej greqishtes (*βάπτισμα, δαίμων*), jo prej latinishtes (*baptisma* khs. it. *battésimo, daemōnem*). Ashtu edhe *kandër* «insekt», te Gj. Buzuku *kándëri* «bruchus», te F. Bardhi *kanderei* (a gabim shtypi?) «locusta, karkalec», është huazim nga gr. e vj. *κάνθαρος* «scarabaeus», e jo nga lat. *cantharis cantharida*, e cila rrjedh prej gr. së vj. *κάνθαρις*, dhe rron edhe në gjuhët romane. Më anë tjetër, po për këtë arsye, në fjalët *balladër* «ujvarë», *drangua*, *gështenjë kështenjë*, *kishë*, *kulshedër kucedër*, *kuxój guxój*, *munëg murg*, *pagëzój*, *përrallë*, *shpatë*, *i vorfën i varfër*, huazimi duhet të jetë kryer nëpërmjet latinishtes (*baráthrum, dracōnem, castanea, ecclesia ecclesia, chersýdrus, cottizare, monachus, bapti-*

66) Për këtë fjalë khs. G. Rohlfs, *Etymologisches Wörterbuch der unteritalienischen Gräzitat* 886, *Lexicon graecanicum Italiae Inferioris* 208; Meyer-Lübke *REW* 1614.

67) L. Ugolini, *Albania antica I*, figura 18; N. Valmin, *Das adriatische Gebiet in Vor-und Frühbronzezeit* 78v.

68) A. Debrunner, *Reallexikon der Vorgeschichte* IV 525.

69) *Zeitschrift für slavische Philologie* V 289, *Die griechischen Lehnwörter im Serbo-Kroatischen* 82.

70) *Balkan-Archiv* III 267.

zare, parabola, spata, orphanus), jo drejtpërdrejt prej gurrave greke të këtyre fjalëve, βάρανρον, δράκων, κάστανον εκκλησία, χέρσυδρος, κοτύζω, μοναχός, βαπτίζω, παραβολή, σπαθή, ὄρφανός. Kështu edhe *frashuell* «groshë» është lat. *phaseolus*, *fasule* gr. e re φασούλι; *këshyre* *kshyre* «shteg nëpër grykën e një mali, rrugë e vështirë nëpër një mal» është lat. *clausūra*, *klisyrë* me të njëjtin kuptim është gr. e re κλεισούρα; edhe *shpnetkë* *shpretkë* është lat. *spleneticum*, *splinë* «shpretkë» gr. e re σπλήνη; *parriz* lat. (it.) *paradisus*, *parajsë* huazim më i ri i gr. së re παράδεισος. Kështu edhe *profët* e *idól* janë huazime librore (savante) nga lat. *propheta* e *idolum*, *profit* dhe geg. veriore (letrare) *idhull* shm. *idhuj* vijinë prej gr. së re (ose të mesme) προφήτης e εἰδωλον; gjithashtu edhe *lëmoshë* e *këmbonë* janë të burimit latin-roman, *eleimosin* «mëshirë» e *kambanë* të gurrës greke. Shohim kështu se në këto fjalë pasqyrohet lëkundja e Shqipërisë mesjetare midis kishës perëndimore edhe lindores, krejt ashtu si dhe në emrat e shenjtorëve e të muajve *shëmitër*, *shëmëhill*, *shëndrë* etj. Duhet thënë ndërkaq se jo gjithçka mund të ngërthehet në këtë rregull, sidomos jo ato forma që si në greqishten si në latinishten e kanë theksin në të njëjtin vend të fjalës e të pandryshuar. Aty, përveç *sharp-it* (nga σίλφιον ose nga *serpum*) që u zu ngoje më lart, hyjnë, ndër të tjera, *jerm* «shkretëtirë» (bashkë me *jeremi* «murg që rron në vetëmi, vetëmi e murgut; vetëmi»), e cila mund të ketë ardhur nga *ερημος* ose nga *eremus*. Po kjo gjë vlen dhe për *kem kënjëm qem* «thimjamë, temjan» në lidhje me gr. θυμίαμα e lat. *thymiama*, si edhe për *mëni mëri* në lidhje me gr. μῆνις, e me lat. *mania*, që rrjedh vetë prej gr. *μανία*. Për disa fjalë të tjera vjen në vështrim një gurrë e tretë, as greke as latine, e cila u përsjati dhe më sipër për fjalën *kandër* «lecythus». Kështu p.sh. për *mollë*, për të cilën janë menduar si burim lat. *melum* ose gr. μήλον, dor. μάλον, mbi dëshminë edhe të hetit. *mahlu*, në parim mund të vijë në vështrim një rrjedhë prej shtresës mesdhetare. Ky barrazim atëherë do të hynte po në atë sistem ku bëjnë pjesë edhe *venë verë* me gr. φοῖνος lat. *vinum* armen. *gini*. Kësaj shtrese i përkasin pas gjase edhe *lërjetë* e *mëllagë*, shpjegimi i të cilave me mjetet e greqishtes së vjetër (λάπαδον \*λαπάθη, μαλάχη) ose të latinishtes (*lapathum*, *malva*) ndesh në vështirësi barabar të mëdha<sup>71</sup>. Ka ardhur koha që për një gjuhë të zonës së Mesdheut, siç është shqipja, substrati mediteran (mesdhetar) të merret në vështrim në një shkallë më të madhe. Aty ndër emrat e bimësisë mund të hyjë edhe *shegë* bashkë me gr. σίδη «shegë». Nga emrat e shtazëve le të përmendim *ngjalë-n*, rrjedhimi i së cilës prej lat. *anguilla* (ose prej gr. ἔγγελος) bie në kundërshtim me ligjet fonetike të shqipes. Forma e saj na çon te një bazë \**engella*, e cila është e krahasueshme me Ἐγγελάνας (si të thuash «njerëzit e ngjalave»), emrin e banorëve ilirë në breg të Liqenit të Lyhnitit (Ohrit), që quhen kështu te fqinjët e tyre helenë<sup>72</sup>. Edhe një tjetër emër shtaze të shqipes, *bretëk* «bretkosë», as baza greke (βρόταχος, \*βροθακος) as baza latine (\**brotacus*) që me-

71) Raporti fonetik që ekziston midis μαλάχη edhe mëllagë, në punë të g-së është i njëjti si ai midis βάριχου, ἄρνες «shtjerra» (Hezikue) e vargër, vërgá «dash a skjap (edhe kalë) i patredhur», dy fjalë që unë i bashkoj në punë të etimologjisë së tyre.

72) Për emrin e këtij populli P. Kretschmer, *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache* 75 shën. 1, 271 shën. 1.

ndohen aty, nuk arrijnë ta sqarojnë kënaqshëm. Le të shënojmë në këtë mes që burimi i tretë nganjëherë mund të jetë semitishtja, si p.sh. te fjala *thes thas*, e cila, ashtu si gr. *θάσχος*, duket se rrjedh prej *śaq* «thes» të fenikasve. Sikundër shihet, koncepti «mesdhetar» përfshin rryma gjuhësore llojesh të ndryshme, të cilat i bashkon lidhja gjeografike. Shpeshherë ndërkaq aty do t'u sillemi gurrave anase të shqipes, si, bie fjala, te *gëzof* përballë gr. *γαυσάτης* «lloj shajaku me thakë» e lat. *gausapa*<sup>73</sup>, e të *shterpë* (rum. *sterp*), të cilën kanë dashur ta afrojnë herë me gr. *στέριφος* «shterpë», herë me një lat. *\*extirpis* *\*extirpus* që nuk dëshmohet gjëkund. Me siguri fjalë vendi në shqipen, sikundër e kam treguar më një vend tjetër<sup>74</sup>, është *shark* m. «zhgun leshi, i zi ose i bardhë, pa mëngë e me thekë, bërruc», *sharkë* f. «mantel burrash prej leshi të bardhë, flokatë», për të cilën prandaj as lat. *sarica* «mëndafsh», as një gr. *σάρικα* «lloj bërruci» nuk vijnë në vështrim.

Jo më pak të rëndësishme, po gjuhësisht më të kapshme janë ato elemente — mjaft të shumta — latine, të cilat kanë hyrë në gjuhën shqipe me anë të greqishtes së mesme ose të së resë. Në këto huazime indirekte, tërthore, bëjnë pjesë, ndër të tjera, *alisivë* «finjë», *aspër* «monedë e vjetër e argjentë; të holla, pare përgjithësisht», *fasule*, *flamur*, *jenár*, *kaliqe* «nallën», *kallamár*, *kamare*, *kandil*, *kapistër*, *kukur* «këllef i ku mbahen shigjetat», *kumërq* «doganë», *kusár*, *llukanik* «suxhuk», *manale* «shandan i madh i kishave», *maqilí* «kasaphane, gjakderdhje, plojë», *marúl* «bimë barishtore që hahet si sallatë», *margaritár*, *mësallë* «pëlhurë e tryezës së bukës, tryeza vetë, sofrë; darkë, gostë», *misúr* «pjatë e thellë», *pallát*, *përmiqýr* «ai që thërret fshatarët në mbledhje, kasnec», *rrogë*, *skiftër* *skyfër*, *spináq*, *varvát* «i patredhur (për kuaj e dema)», *Khtë* (vit) «vit që më çdo katër vjet e ka frorin 29 ditsh», e *vlë*<sup>75</sup>. Nëto fjalë, së bashku me ato që u zunë ngoje më sipër, tregojnë që në gjuhën shqipe, e cila edhe gjeografikisht gjindet ndërmjet latinishtes e greqishtes, kryqëzohen ndikimet latino-romane me greket. Rolin e Bizantit si vatër rrezatimi për leksikon latin të gjuhëve ballkanike e ka vënë në dukje P. Skoku<sup>76</sup>. Prej kësaj periode të greqishtes, në pajtim me kriteret që caktoi A. Thumbi (në studimin e cituar, f. 7v.), duhet të burojnë në gjuhën shqipe ato huazime që janë dhe në gegërishten, pra, ndër ato që u përmendën më sipër, p.sh. *aspër*, *flamur*, *kapistër*, *kukur*, *kusár*, *margaritár*, *mësallë*, *përmiqýr*, *qiri*, *rrogë*, *skyfër*. Aty hyn edhe fjala *vistár* (sot *visár*), e cila, për mendimin tim, së bashku me rum. *vistier* «arkë e visarit; ruajtës i visarit», rrjedh prej *βιστάριον*, *βιστιάριον*, *βεστιάριος* të administratës bizantine, e kjo prej lat. *vestiarius* «ruajtës petkash», khs. titullin *protovestiarius* nëpër dokumentet e Shqipërisë mesjetare<sup>77</sup>. Veçse edhe në këtë fushë do pasur parasysh se paraqitet nevoja e një rishqyrtimi të materialit, për të veçuar elementin e huazuar latin të marrë drejtpërdrejt, nga ai që u mar me ndërmjetësi

73) Khs. N. Jokl, te Walde-Hofmann I 585.

74) *Lingua Posnaniensis* VII 179vv., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 53vv.

75) Khs. sidomos G. Meyerin në *Neugriechische Studien* III passim. Për *manale* sh. Pedersenin KZ 33, 540; për *mësallë* Helbigun 78; për *mërmiqýr* sh. Joklin IF 44, 62v.

76) *Byzantion* VI 731vv.

77) *Acta Albaniae* I 725; II 706.

të greqishtes. Kështu p.sh. fjala *shtupë* «pjesa e trashë që nxiret prej lirit e prej kërpit, kur e krehin; tapë; sukull», gurrën e drejtpërdrejtë të së cilës e kanë kërkuar në gr. e re *στυπί*, bashkë me rum. *stupă* mund të ketë rrjedhur fill prej lat. *stuppa*, ashtu si mendojnë Meyer-Lübke me S. Pušcariu. Kështu do menduar tani edhe për *kurorë* *kurorë*, rum. *curună curună* «kurorë; vënie kurore, martesë», pas trajtimit që i bëri N. Jokli kësaj fjale<sup>78</sup>. E diskutueshme është përkundrazi çështja e burimit të pandërmjëmë të fjalës shq. *kurt* rum. *curte* «oborr» nga lat. *cōrtem*, ku është menduar dhe për një ndërmjetësi të gr. *κοῦρτα*, *κοῦρη*. Edhe për *gunë* rruga e huazimit është e paqartë. Një fjalë thjesht greke është pas gjase *kallambóq* «misër», e cila nuk ka të bëjë aspak me lat. *columba* «pëllumb», po lidhet me gr. *καλαμπόκι* «misër», kjo nga *κάλαμος* «kallm». Me siguri prej greqishtes rrjedh *kapasë* «qyp i madh për vaj», fjalë me përdorim në pjesën më jugore të vendit, tama e së cilës, *καπάσα* (prej lat. *capasia*), gjindet e trajtuar te G. Rohlfsi<sup>79</sup>.

Elementet latine që kanë depërtuar në shqipen me anë të sllavishtes ballkanike nuk përbëjnë problem. Ato janë fort të paka me numër. Bëjnë pjesë në të p.sh. *bozilók borzilók*, pastaj *kolendra*, shm. «nata para natës së kërsëndellave; dita e fundit e vitit» krahas me *kullana këllana* «dita e fundit e vitit, nata e motmotit të ri; bora e parë» e me *kallënduor kallënduer* «kallnuer», *rusica* shm. «gjysma e pendikostisë», dikur «e kremte e besimit ortodoks 25 dit pas pashkëve» pranë *rusalë* «grua lëlë, fëllegë», dhe *rrëshajë* shm. «festë e krishterë 50 dit pas pashkësh», kjo prej lat. *rosalia*; khs. për këto rum. *colindă* «këngë që këndojnë kalamajtë nëpër rrugë e portë më portë natën e kërsëndellave e të motmotit të ri» pranë *cărindar* «janar», dhe *rusalia* «rrëshajet». Te *bozilók borzilók* e te *kolendra*, o-ja në vend të a-së është shenja e burimit të tyre prej sllavishtes. E njëjta gjë vlen edhe për *konóp*, përkundrejt *kanëp kërp*, që vjen drejt prej latinishtes (*canapis*), dhe për emrin e enës *kondír* përkundrejt *kandër* që u përmendën më lart, gjithashtu edhe për *gastare* e për *leqikë loqikë* «marule; radhiqe». Rasa të tjera, si *ajër*, *bush* «shimshir», *gabonjë* «shqype», *grosh*, *kokme* «enë e vogël prej teneqeje për të mbushur ujë; ibrik i madh për të zier kafe; kumbara për pare e kalamajve», *krezm*, *kubël*, *maj* «çekan i madh i farkëtarëve; tokmak i drunjtë e i trashë i samarxhive», *mel*, *shpenxë shpenzë* «shpenzim», *shqyt*, *shtrigë*, me siguri janë huazime pjesërisht latine, pjesërisht latino-romane. Gjithashtu edhe *gutë* «përdhes, cermë» mund të ketë ardhur drejtpërdrejt prej latinishtes (Meyer-Lübke), ashtu si rum. *gută*. Ndër forma fjalësh të tjera, *predk* vjen prej italishtes, *petë* nuk vjen prej sll. *peta*, dhe *shkalc* «tezgjere, tezgë» me siguri nuk ka dalë nga ndonjë \**skalica* e sllavishtes; *rus* «flokkuq, qimekuq» ka aq mundësi që të jetë gr. e re *ρουσσοσ* sa edhe sll. *rusъ*. Për arsyë fonetike, edhe për *humë* «botë me të cilën gratë lajnë kryet», *kumí* «furrë tjegullash» edhe *repë* vjen eventualisht në vështrim një burim prej sllavishtes (*rapë* «repë» rrjedh prej it. *rapa*). Te *karinë* «trau i përposhëm i anijes» me P. Skokun do të shohim një huazim me gurrë serbokroato-dalmate.

78) *Balkan-Archiv* IV 206vv.

79) *Griechen und Romanen in Unteritalien* 139; *Etymologisches Wörterbuch der unteritalienischen Gräzität* 897; *Lexicon graecanicum Italiae Inferioris* 210.

Për fjalët *belbicë* «lloj trofte e liqenit të Pogradecit», *kup* «grumbull, tok» edhe *pod* «kat i shtëpisë; shesh; vend i lartë i sheshtë, vend më i ngritur se pjesa tjetër në një dhomë, në një sallë» do të pranohet tani që janë huazime thjesht sllave. *Kade* «lloj fuçie për djathë, bulmet, turshi etj.», të cilën e ka dhe rumanishtja, merret për një fjalë shtegtare me gurrë hebraiko-greko-latino-sllave.

Fjala *skele*, që gjindet edhe në të tjerat gjuhë ballkanike, sikundër ka treguar Max Leopold Wagner<sup>80</sup>, ka shkuar tek ato me anë të turqishtes. Një rrugë po aq me lakadredha ka përshkuar fjala *centenarium* «njësi peshe njëqind pjesësh» e latinishtes mesjetare, që nëpër gr. e mes-me *κεντενάριον* depërtoi në arabishten e në turqishten (*kantar*), e cila ua kaloi gjuhëvet ballkanike (shq. *kantár* *kandár*, gr. e re *καντάρι*, serbokr. *kántar*, bullk. *kantar* etj.)<sup>81</sup>. Ashtu qëndron puna dhe me lat. *gaitanum* «brez», e cila nëpërmes gr. *γαϊτανόν* kaloi në turqishten (*gaytan*), prej nga e morën gjuhët e Ballkanit duke përfshirë aty edhe shqipen; ashtu edhe me fjalën *qilér*, me burim prej turq. *kiler*, kjo prej gr. *κελλάριον*, e cila nga ana e saj rrjedh prej latinishtes.

Pamja e përmasave të ndikimit latin mbi gjuhën shqipe nuk do të delte e plotë, po mos të caktoheshin edhe caqet që e ndajnë prej lëndës gjuhësore të vendit. Karakteri i shqipes si një gjuhë indoevropiane dhe si e tillë e afër me latinishten, ka përfutur në të forma fjalësh që janë të gjashme me format e latinishtes. Në këto rrethana nganjëherë nuk është e mundur të ndahet nëse ato janë huazime latine apo burojnë prej gurrash vetjake të gjuhës. Në këtë çështje dihet se që nga ditët e Gustav Meyerit gjendja ka ndryshuar. Me punën sidomos të Holger Pedersenit, Kristian Sandfeldit, W. Meyer-Lübkes e Norbert Joklit, e cila ka hapur një ravë të re në këtë fushë, burimet vendëse të visarit të fjalëve janë bërë më të dukshme, dhe mendimi për shqipen si një gjuhë e përzier gjysmëromane, i cili shfaqet që te Franz Boppi (f. 532), tash thuhet më nuk përsëritet. Do të pranohet që Gustav Meyerit ndikimin latin në shqipen e ka mbiçmuar. Po duhet thënë për të përligjur dijetarin e madh, që materiali që pat nëpër duar ai, edhe si vëllim edhe me mënyrën si ishte bërë i njohur, ka qenë i paplotë, shumë më i paplotë se sot. Me zbulimin edhe njohjen e përmendoreve të vjetra letrare dhe me një gjurmim më të mirë të dialekteve ka dalë në shesh një lëndë leksikore e re, në të cilën krahas me disa huazime që nuk diheshin më parë, përmbahen edhe fjalë me burim vendi që kanë dalë rish-tas në dritë.

Në qoftë se duam të rrokim ndikimin e latinishtes në tiparet e tij kryesore, duhet ta gjurmojmë atë në anët e ndryshme të sistemit gjuhësor të shqipes.

Ndonjë ndikesë në punë të tingujve nuk vihet re gjëkund. Mënyra si është trajtuar fonetikisht leksiku i burimit latin na jep një ide për sistemin fonetik të shqipes si ka qenë në periudhën romake, për fonemat me anë të së cilave u reflektuan fonemat latine kur hynë huazimet. Kjo mënyrë reflektimi në vijat e saj kryesore dihet. Vetëm disa pika të veçanta janë në diskutim ose ende jo të sqaruara sa duhet:

80) *Zeitschrift für romanische Philologie* 39, 96vv.

81) Për këtë fjalë tani së fundi M. L. Wagner në *Vox Romanica* IV 258.

Në vokalizëm mënyra e trajtimit të *e*-së së gjatë, reflektimi i dylojshëm i *o*-së së theksuar në ballë fjale (*orphanus: i vorfën i varfër* përkundrejt *opera: vepër, orbis: i verbër*, khs. veljotisht *vuarb*) edhe në trup fjale (*corvus: korb* përkundrejt *spodium: shpuzë* «hi i nxehët, i përzier me prushe të vogla», *ordinem: urdhër*) ashtu si në rumanishten, reflektimi dy llojesh i *o*-së së gjatë (*pōmum: pemë, po canōsa, canōsus: kanushë* «lejlek») dhe i diftongut *au* (*aurum: ar; laudem: lavd, causa: kafshë*), metafoia *a:e* (*imperator: mbret, galbinus: gjelbër*) dhe «thyerja» *e: i* (*gjind prind qind* përkundrejt *mend; grigj ligj* përkundrejt *regj* «mbret»); në konsonantizëm veçanërisht reflektimi dy llojesh i grupit *gn*, si *nj* dhe si *ng*, në *signum: shenj sheng*, dhe reflektimet e ndryshme të grupeve *ct* dhe *cs* (*x*), për të cilat u fol më lart (f. 15vv.). Le të shtojmë dhe këtë, që *o*-ja e gjatë para nazaleve e likuidave që mbyllin rrokjen, përherë u diftongua, nuk u kthye në *e*, prandaj etimologjitet *honōrem: ndër, timōrem: tmër*, që vlenin gjer më sot, më nuk qëndrojnë. Lat. *s* nuk ka dhënë asgjëkund një spirant interdental, sepse *thekër, thikë* (bashkë me foljen *thek*) nuk kanë kurrsesi të bëjnë me këtë të pretenduar ndrim fonetik e as me latinishten a me ndonjë gjuhë romane<sup>82</sup>. Mënyra e trajtimit të *k*-së përpara një *e*-je a *i*-je u përmend më lart (f. 16). Mënyra e reflektimit të tingujve *l* në periodën e moçme, që përfshin edhe elementin latin, është caktuar përfundimisht prej H. Pedersenit<sup>83</sup>. Një pikë vetëm desha ta shikoj këtu më nga afër. Reflektimi i lat. *lj* (*lj, lē*) në disa rasa me *l* velare në vend të refleksit të zakonshëm *j l*, si e vuri re ky gjuhëtar, pra *consilium: këshill, vigilia: mëngjille mnjille, evangelium: ungjill*, përkundrejt *familia: fëmijë fëmilë*, ky reflektim vërehet në shqipen dhe në disa forma të tjera. Aty hyn fjala *bollë* «një gjarpër i madh, Callapeltis Aesculapii; gjarpër përgjithësisht» prej lat. *bolea*, fjalë e studiuar prej N. Joklit, pastaj fjala *tallë* «Sorghum halepense, vulër; koçan misri, rrum; kashtë e misrit», të cilën unë e rrjedhoj prej lat. *talea* «stap i vogël, fidan», një fjalë që rron përndryshe vetëm në italishten. Fjalën *kërshëndelle* G. Meyeri e bie të ardhur prej *Christia natalia*, po Pedersenit me të drejtë prej *Christi natale*. Mendimi se lat. *solea* edhe *solum* rrojnë me të vërtetë të dyja në gjuhën shqipe, e para me *shollë* dhe e dyta me *shuall*, ky mendim më duket krejt i dyshimtë. Rënia e gjysmëzanores që solli velarizimin e likuidës në fjalët më sipër, pas Pedersenit u krye që në truall të latinishtes, pas N. Joklit më konkretisht në latinishten provinciale të Ilirisë, prandaj dhe ky dijetar *bollë* e shpjegon prej një *\*bola* të latinishtes. Për këtë mendim nuk japin ndonjë dëshmi, si mendon Pedersenit, fjalët *shok* nga *socius* edhe *lak* nga *laqueus* (pas G. Meyerit nga një *\*laquus*): për *lak* s'është e sigurtë që të jetë huazim prej latinishtes; *shok* dha në shqipen pikësëpari *shoq*, prej nga u sajua *shok* me analogji pas *mik*, *shm. miq* etj. (G. Meyer f. 412). Çojnë kandar përkundrazi format *blatta* e *capra*, në vend të *blattea, caprea*, të cilat vë në dukje Jokli. Që kjo dukuri në fushë të tingujve *l* ka qenë në latinishten më e përhapur, këtë e dëshmojnë forma të tilla si *filus* për *filius, Aurelus* për *Aurelius, Emela*

82) Khs. *Lingua Posnaniensis* VIII 92, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 107, 176.

83) KZ 33, 535-551.

për *Aemilia*, prej Galie. Këto forma atëherë nuk duan marrë, me C. Battistin, si të dyshimta<sup>84</sup>, sa kohë që tani nga fusha e iliroromanishtes ka forma si \**bōla*, \**consilum*, \**vigila*, \**evangelum* (khs. it. *vangelo*), \**tala*, mbase edhe \**sola*, të cilat u përgjigjen atyre.

Në lidhje me theksin do të themi se — sikundër vuri re P. Skoku<sup>85</sup> — shqipja vendin e theksit latin përbrenda fjalës e ka ruajtur në mënyrë shumë të rregullt: *pollicaris: pulqér* «gishti i madh i dorës», *canata: kënatë* «enë dheu për ujë, shtamë» etj. Sikundër u tregua më lart (f. 35v.), theksi shpeshherë përbën një gur prove për dallimin e huazimeve latine nga huazimet greke. Për këtë arsye unë, së bashku me këtë dijetar, në emrin e sotëm të qytetit *Durrës* nuk gjej refleksin e lat. *Dyrrhachium*, po as dhe — si mendon ai vetë — refleksin e sll. *Дѣрачь*, po gjej vazhdimin e gr. së vj. *Δυρράχιον*, duke ruajtur aty v-në (ypsilonin) dorike-greke perëndimore si *u* si edhe vendin e kryeshëm të theksit<sup>86</sup>.

Me çështjen nëse është ndikuar sistemi i formave gramatikore të shqipes nga latinishtja, janë marrë gjuhëtarët në kapërcyell të shekullit të kaluar, veçse kjo çështje tani mund të quhet e zgjidhur. H. Pedersenit sidomos i detyrohet konstatimi që fundori -i i shumësit (në *pleq* etj.) nuk e ka tamën në të njëjtin fundor të latinishtes, as përemri *kuj* në *cuius*, as mbasea foljore -oj në -are, as aoristi i tipit *këndova* në roman. (it.) *cantavo* lat. *cantabam*, as dëshirorja *këndofsha* në *cantavissem*. Rezultati i Pedersenit, që ndikimi latin në fleksion të shqipes është baras me zero, në një pikë ka nevojë ndërkaq për një plotësim. Është afër mendsh të mendohet që trajta e perfektit të rrethshkruar me foljen *kam*, tipi *kam shkruar*, rum. *am vāzut* «kam parë», gr. e re *ἔχω δεῖμένο* «kam lidhur», sipas hullisë së B. Havranekut<sup>87</sup> buron prej romanitetit ballkanik. Ky mendim është më afër mendsh se mendimi i përkundërt i M. Mateckit, i cili gjen në këtë dukuri një tipar ballkanik me burim prej një substrati të lashtë, trashëgimtarja e të cilit sot sipas tij është gjuha shqipe<sup>88</sup>. Në formim të kësaj trajte kohore latinishtja u bë model jo vetëm për gjuhët e një treve siç është Gadishulli ballkanik, që aq gjatë dhe aq mendisiviht iu shtrua ndikimit romak, po edhe — sikundër ka treguar Antoine Meillet<sup>89</sup> — për gjuhët gjermanike, të cilat gjinden më larg. Për shqipen kjo ndikesë duhet të pranohet së paku për perfektin e foljeve transitive e pastaj edhe të foljeve intransitive. Për të tjerat kohë të këtij tipi formash (pluskuamperfekti dhe futuri i dytë i dëftores: *kisha shkruar*, *pata shkruar*, *do të kem shkruar*, perfektin i lidhores të *kem shkruar*, kushtorja e kaluar *do të kisha shkruar* etj.) mund të kemi të bëjmë me shtrirjen e një parimi gramatikor të ngulitur tashmë në gjuhë. Një çështje e dytë është kjo, a është përfutur edhe forma e mediopasivit (mesorepësore) e tipit *jam vrarë* sipas gjedhes

84) *Avviamento allo studio del latino volgare* 150.

85) *Arhiv za arbanasku starinu* II 111v.

86) Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore 2 (1958) 60v.

87) *Mélanges Hashkovec* (1936) 147vv., 388v. = *IJ XXII VII* 145. Edhe Kostaq Cipo, në një kumtim me gojë.

88) *Sprawozdanie Polsk, Akad. Umiejtn.* 40 (1935) 25 vv. = *IJ XXI VII* 129.

89) *Linguistique historique et linguistique générale* 142.

së lat. *occisus sum* «jam vvarë». Për të formuar një gjykim të drejtë për këto forma në pamjen e përgjithshme e tërësore të ndikimit gjuhësor të latinishtes, duhet ndërkaq të shënohet që në zgjedhimin perifrastik (rrethshkrues) të veprës (aktivit) me *kam* (dhe të mediopasivit me *jam*) nuk kemi të bëjmë me një ndikesë mbi sistemin e formave gramatikore, po më fort me një kalk (përkthim) gramatikor, me shkërbimin (imitimin) e një forme shprehore të huaj me mjetet e gjuhës amtare. Lindja dhe zbatimi me sukses i formave kohore të përbëra në dëm të kohëve të thjeshta, në shqipen pas gjase ka lidhje me zhdukjen e mbaresave të moçme të kohëve të shkuara të foljes dhe me nevojën e lentimit (krijimit) të një kohe foljore të re të veprimit të kryer. Në pikëpamje të kohës, ky formim pas gjithë gjasësh bie në fazën e sprasme të ndikimit latin: gotishtja, e cila edhe ajo u shkrua së pari në Gadishullin ballkanik (në Mezi) në shekullin e IV. të erës sonë, sipas A. Meillletsë nuk e ka, ashtu si nuk e kanë, sipas H. Mihäescut (f. 145), as burimet shkrimore të provincave romake danubiane.

Në lidhje me trajtimin e formave gramatikore do të shënojmë se gjinia e emrit të latinishtes u ka ruajtur në shqipen në mënyrë mjaft konsekuente. Vihet re kështu që femërorët e të ashtuquajturit lakim i tretë i tipit *sortem, civitatem*, në kundërshtim me mendimin që ka zotëruar gjer sot (ish. më lart f. 24), përdoren në shqipen si të tilla, me hiferezë të *e-së* fundore, dhe vetëm në fazën më të renë të gjuhës kanë kaluar në mashkulloren (nëpër dialekte edhe në femërorët më *-e* ose më *-ë*): *short shortja, qytët qytetja*, sot *short-i* m., *qytët-i* m., krahas me këto edhe *shorte*, e *qytetë-a*. Nuk është vënë re gjer më sot që kjo kategori fjalësh në fushë të shqipes ka gjetur truall mbështese në një klasë nominale vendëse e të lashkët femëroresh, e cila sot përfaqësohet vetëm me disa pak rasa si *djep djepra, end endja* «lulja», *et etja, gjeth gjethja, lot lotja, mnër mnerja* «tmeri»; ndër *nderja*. Aty hyjnë edhe disa emra visesh, si *Mat Matja, Mjet Mjedja*, të cilat i trajton N. Jokli te *Slavia* VIII 616v., 628. Sikundër u tha edhe më lart (f. 18), shqipja, si e vuri re H. Pedersen<sup>90</sup>, ndër huazimet që ka prej latinishtes, ka ruajtur dhe neutrin si të tillë. Përveç atyre që jep ky dijetar, d.m.th. *rete: rjetë, oleum: vaj, linum: li, aurum: ar*. (*granum: grurë* nuk vjen në vështrim), po përmend këtu *damnum: damtë, \*fallium* (në vend të *fallum*): *faj, frenum: frëtë, iudicium: gjyq, pignus: penktë, saeculum: shekull, signum: shenj, stratum: shtrat, unguentum: unguënt*, të cilat në përmendoret e vjetra të shkrimit dalin herë si neutra, herë si mashkullore; ndryshe nga *argentum: argjand, aurum: ar, evangelium: ungjill, peccatum: kat mpkat mëkat*, të cilat paraqiten aty si mashkullore, dhe nga *caelum: qiell, infernum: ferrë ferë*, që shfaqen aty vetëm si femërore<sup>91</sup>.

Për ndikimin latin në gjuhën shqipe karakteristike është edhe kjo, që ai ka përfshirë dhe fjalëformimin e kësaj gjuhe. Hyjnë aty sidomos disa sufikse që shqipja më të shumtën i ka të përbashkëta me rumanishten dhe që i ka marrë prej latinishtes ballkanike. Më të shumtat ndër të janë bërë produktive në gjuhë. H. Pedersen, në lidhje me sufiksin *-im* dhe raportin e tij ndaj lat. *-imen*, ka tërhequr vëmendjen mbi rre-

90) KZ 34, 287 e 289.

91) Khs. vërejtjet tona në *Buletin për Shkenca Shoqërore* 3 (1955) 43v.

thanën që popullariteti i këtij sufiksi latin në shqipen ka lidhje më ekzistencën e një sufiksi vendës me trajtë të gjashme me të <sup>92</sup>. Ashtu afërsisht e gjykon edhe Meyer-Lübke ndeshjen e lat. *-tor* me një *-tor -tuar* të lashtë të shqipes me burim prej indoevr. *-tēr = gr. τήρ* si në βατήρ «prak, bazë», dhe ndeshjen e lat. *-ōne* me shq. *-ua* me burim prej një të lashte *-ōn* prej indoevr. *-ēn = gr. ἦν* si në πομῆν «bariu»<sup>93</sup>, pas mendimit të tij bile mund të shkohet mbase edhe një hap më tej e të mohohet qdo farë lidhje midis *-tuar-it* të shqipes dhe *-tor-it* të latinishtes. Afërsisht ashtu edhe Leo Spitzer është i mendimit që lat. *-anus* si në *orphanus* u shtri në shqipen përbmi një sufiks vendës *-ēn -ērē*, si në *vorfēn varfēr*, me rrjedhë prej indoevr. *-enos*<sup>94</sup>.

Më në fund disa vërejtje për leksikun, ku ndikimi latin, sikundër dihet, është më i fortë se në të gjitha fushat e tjera. Këtu si gjuhëtari krahasimtar si romanisti gjinden para detyrës që, duke u vënë mend vazhdimisht ligjeve fonetike të shqipes si edhe rrethanave që vërehen në rumanishten, të japin një pamje sa më objektive për vëllimin e përmasat e latinishtes. Puna e kryer gjer sot, me gjithë rezultatet e rëndësishme që ka arritur, në punë të metodës ka vuar në këtë pikë, që ajo e ka tepruar me mundësitë gjuhësore të latinishtes ballkanike, e që më anë tjetër ka nënçmuar mundësitë indoevropiane dhe vitalitetin e shqipes. Në parim ekzistenca e një huazimi latin në shqipen në rasat ku nuk ka analogji në gjuhët romane, nuk do të mohohet; latinizma të tilla që shfaqen vetëm në fushë të shqipes, ka me të vërtetë; khs. më lart f. 19v., duke shtuar aty edhe *caltha: i kaltër, chersýdrus: kulshedër kuçedër, \*salviella: sherbelë (gjetkë salvia), \*testimoniare: dëshimój, \*trimensana: tërshanë tërshërë, avlémënd «vegj, tezgjah»* sipas M. Lambertzit prej lat. *aulaeum* gr. *αύλεια* «e endur, pëlhurë që ndan dhomën e ndejtjes prej oborrit; petk, mantel» + lat. *-mentum*<sup>95</sup>, ku në punë të formës do shtuar dhe *gazmënd* nga *gaz* prej lat. *gaudium* + lat. *-mentum*, duke pasqyruar kështu, si të thuash, një lat. *\*gaudimentum*; më në fund<sup>96</sup> *ushqej* nga *vescor*. Me gjithë praninë e këtyre formave, përgjithësisht do thënë se nga bazat latine të rindërtuara për shqipen e të pajisura me një \*, më të shumtat pjesërisht janë a priori, që në thelb, të gabuara, pjesërisht problematike, ngase nuk pajtojnë ose me rrethanat e latinishtes ose me kushtet e shqipes, ose me të dyja njëheret. Nga këto kategori, më lart. f. 22vv, në lidhje me rumanishten, u dhanë disa shembuj. Përsa u takon rasave që i përkasin vetëm shqipes, disa interpretime etimologjike që janë të pamundura, ose janë vënë në dukje si të tilla nga ana e dijes së mëpastajme, ose kanë rënë me kohë vetvetiut. Hyjnë aty barazime të tilla si *aberrare: harrój, \*ablevare: blej, acucula pani: gjylpanë gjilpërë, aetas: jetë, \*affinare: afëroj, \*aginculus: qengj, \*aliellum: rryell «Euphorbia, qumështore», \*alterūsius: ndryshe, \*apeta \*abetta: bletë, area ose arvum: arë, \*aviūsius: gjysh, baca: bagjë balgë bagël, basilica: bjeshkë, belva: bollë, \*belvulonia: buronjë «lloj*

92) Kritischer Jahresbericht für die Fortschritte der romanischen Philologie IX I 212.

93) Mitteilungen des Rumänischen Instituts Wien I, 25 v.

94) Mitteilungen des Rumänischen Instituts Wien I 334.

95) KZ 53, 304.

96) G. Reichenkron, Völker und Kulturen Südosteuropas, 1959, 161.

gjarpëri që i mbështillet njeriut a shtazës përreth», \*bestana: shtazë, \*bullana: mullâ mëlË mëlËri, burgus: burg, \*bursinum: bulçi «ana e brendshme e faqes, nga goja gjer te veshët», caducus \*cadocus: keq, \*cantile: skundill «pëqi, shpëlqi i petkut, kind», \*cardella: rrodhe rrudhë, caries: qërój, caulae: zgavë, \*cavanus: govërë «gropë», \*cedrulanea: dëllenjë, clarus: i qartë, coliculus: kreçe «kokëllakër», colostru: qumësht, convertere: kthej, \*copilis: kopil, \*coriatum: gujatë «guall, guaskë, gëlvozhë», cornea: shkurre, \*corymbellus: gallabere garabelle «lule e çelur fort», crassus: i trashë, \*cristalis: rrâ rrajë «krimb që zënë zorrë sidomos të fëmijës, bubë», \*culleus: kulë «të rrënxuarit, të dëkuemit, hernia», \*disbonare: dëbój, \*discarpere \*excarpere: shkarpë «karthje», \*dispungere \*expungere: shpoj, \*disrupare: zdryp, dūmus: dushk, ebrius: egjër, elegium: ligje «vargjet që numëron një grua kur vajton një të vdekur në mort, vejmë, vome», ervilla: rryllë «thjerr» (khs. rryell rriell), \*excallare: shkallój, «luaj menç», excitare: qis, excitare: çoj, \*exquaternare: shkatërrój, \*extrudere: shtrydh, \*extus: jashtë, ex-ungere: shuaj, \*exvigilare: zgjoj, \*fabarium: thjerr, favilla ose \*focile: thëngjill fëngjill, ferio: ther, ferula: ferrë «kërcell», \*filicaria: fier fjer, \*fileolum: fjollë «li i rrahur, i krehur e i ndrequr për ta tjerë» (është identike me fqollë), \*filia: fije, findere: thind «thumb», findere: fëndyell, \*fistulare: frushkullinj «fishkëlloj», flaccus: flak, flare: fle, flētus: lot, flumen: lumë, \*formicula: thënegël, \*frigilinum: fëli fuli, fulica: thëllëzë fëllënxë, fūsum: fushë, grandis: i rëndë, grevis gravis: rë (në vë re), hasta: heshtë, implere: mbloj «mbush», inclinare: qij, \*indictare ose \*doctare: dëftój, initiare: nis, intelligere: gjegjem, inter: ndër, in toto: dot (pjesëz që përdoret për forcim të mohimit), \*intrudere: ndrydh, intus: ndë, \*itio: eci ecënj, lacerta: hardhje «hardhucë», leonem: luán, levis: i lehtë, lilium: lule, lino: lyej, ludo: luaj, \*lugarius lucarius: luar «lopar; beki, pojak», macca: mangë «vegël për të rrahur lirin», maccus: mekem, \*mellitiare: mëlcój «ëmbëlsoj», \*mer(ul)anea \*melaena: mëllenjë mullenjë, molere: bluaj, nepos: nip, \*nepōtia: mbesë, numquam: nuk, \*nuptia: nuse, ōvum: vë, pala: terplote «lopatë e gjerë prej druri për të bajtur e për të hedhur drithë», \*pariolum: pararé paralë «pajatë e përfushtë» percello: përqellë «turp, mbarre, infamia», \*pervigilare: përgjój, \*petio: pyës, pila: pëlzë «guralec», radere: rruaj, \*radicia: rrënjë, rastus: rrashtë «kafkë e kresë, rradake», \*sedicare: shikój, sequi: shkoj, serica: cergë «mbulesë e ashpër; çadër e qepur me copa», sica: thikë, \*signitare: shëmtój, sternere: shtroj, tenebrae: terr, \*tersilis: dërstilë «valanicë», \*totanus: tanë tërë, trivium: trevë, tundo: tund, \*ulnana: llanë llërë, \*utrinum: turí, velarium: lëvere, vicus: vik vig, vidua: e vë, \*virana: unazë. Këtyre po u shtoj këtu ndër të tjera: \*abiignum: vgjë «borgë, pishë e butë, pishë e egër», \*ablūta: bludë «lëmashku i bardhë që zë për sipër vera e prishur», (al)burnum: urrë «pjesa e drurit që prej myjës gjer te zbardhulina, blana, alburnum», alterare: ndërój, arista: rreshtë «asht», bēsta bēstia: bushtër, \*boreanus: murrá murrë murrëri, \*brachiūle ose \*brachiullus: bërýl brul, \*caldūmen: gardūmp «zorrë të mbushura», \*capitiare: kapërcëj, \*capsare ose capessere: kafshój, \*captio: kapshoë (Greqi) «lidhëz, kordelë», carraria: karrarë «udhë», \*casicula: kaçiklë «lafshë e gjelit», chylus: qull, \*clavanus: që qer «dërrasë rrotullare ku hullojnë», \*corymbalis: karumbál «boçë bredhi» (Greqi), \*cremoratum: grëmëratë «ku-

llosh tër», *critare*: gërthás, *curare*: qyrónj «këqyr», *curare*: qëroj, *debeo*: dua, \**decolear*: dëkój «rrah, sqaq më dru; derdh», \**depenetrare*: depërtój, \**depositare*: dështój, \**disfrenare*: dëfréj me gjithë shëfréj «dal e marr pak ajër», \**dulcius*: ndulgur «i pjekur vetui, si të jetë këputur prej peme», \**excambiare*: shkëmbëj, *expeditus*: i shpejtë, *ferula* + *-iciu*: fëliç «tundësi me të cilin rrahin qumështin në dybek», *fisiula*: \**fiscula*: frushkull «kamxhik; thupër, shufër», \**flaca*: flakë, *flare*: flojere «fyell», *foria*: ferrásht «gropë plehrash», \**furcata*: furatë «purtekë për të shkundur ullinj të», *fütis*: *fyt*, *grancer crancer cancer*: gërthje «gaforre», \**gran-culus*: gërthëlë «gërthje, gaforre», *grümulus*: grumbull, *grümus*: grumáz gurmáz, *hibernale*: merajë «kullotë dimri, vërri», \**incalleare*: ngel, \**inc(h)ordare*: ngordh, *incidere*: kij «tëharr hardhitë», *infantia*: fancúk «këlysh shtaze», \**inquaternare*: ngatërrój, *invertere*: mbërthëj, \**disvertere*: zbrëthëj, *labes ose laurus*: llajë «dele e zezë», \**labracum*: labrik «levrek», *laurus*: i larë i larnë me larë «pullë a njollë më fort e bardhë në qime të shtazëve a në pendët e shpendve a të zogjve», *lumbricus*: livrizë «*Taenia solium*, shirit», \**malleaneus*: vullá «lehe, postat» me vëllaja shm. «fidane, mënjolla», \**manātum*: menatë «mëngjes», \**massarium*: amashirë «sahan», \**micetta*: mjetë «lesh i shkurtër që mbetet në fund, kur e zgjedhin leshin, dhe që shtihet në të endur si ind, e përdoret për bërrucë», *ministrare*: mashtroj, \**mūla*: mullë «stomak; bark», *mulcere*: mullkój mëlkkój «i shtie gjellës yndyrë, e mëlmej», \**nodunc (u) lus*: nëng «nye» (Kalabri), \**nubecula*: njejq «një si mjegullinë në mot shirok», \**pant (ic) arium*: pandërë «një copë pëlhurë e qëndisur, të cilën e vënë gratë në mes e përmbi prehër», *parma*: parmzë parzëm «kraharor, gjoks», \**petramen*: bërthamë, *pica*: pikë, \**placium placitum* «padi»: pleq «traktat», \**plicina*: pëqí «sqep e palltos a i petkut, skundill; prehër», *porro*: po, *potestatem*: pushtój, *renovare*: arnoj, *sacculus*: shakull, *sannare*: shaj, *scribere*: shkruaj, *sibulare*: fërshëllëj, *sterilis*: shtjerrë, *stiva*: sti «shtizë e parmen-dës», \**suspiritare*: fshaj, *susurrare* (+gr. συρρίζω): shëshëris (për gjarpërin), *taurus*: tër «dem», *tendere*: dend, \**terriola*: truall, *terrōrem*: drëronj «tremb», *tetrañem*: drënjë «shkurtë (emër zogu)», *transigere*: trashëgój, \**upupula*: puplë «pupëz», \**versire*: fshij mëshij, \**versitio*: fshesë fshisë, \**vertia*: verzë verçë «veshëza e parmendës, llapari», *vescus*: fishkem, \**virganus*: vërgá «dash a skjap (edhe kalë) i patredhur», \**vivularia*: fyell.

Ndër fjalët për të cilat burimi latin nuk përjashtohet, po që mbetet ndërkaj q i diskutueshëm, hyjnë p.sh. \**betula* ose *beta*: blëtëzë «mështekën», \**binati*: binják, \**carputio*: këpús, *circus*: qark, \**corialia*: kurale «armë» (Kalabri), *detegere* ose \**discaptare*: diktój, *et*: e «edhe», *excipere*: shqipój «kuptoj», *excovo*:- zgjua zgjue, *femur*: thembër, *hebdomas*: javë, *hostis*: ushtár ushtrí, \**invelare*: mbulój, *luteum*: lucë «baltë, lym», *medicare*: mëkój koj «i shtie ushqim në gojë të voglit a të sëmurit, ose ndonjë shtaze, si gjeldetit», *patior*: pësój, \**pistarium pistorium*: shtër «havan ku shtypin kripë, piper, hudhra etj.», *praeire*: prij, *quattuor*: katër, *rudis*: rrudhë me gjithë foljen rrudh, \**rugalis*: rungajë «ortek bore; shtrat i një përroi, proskë», *symbolum*: shembëll.

Një grup më vete përbëjnë disa fjalë, të cilat vërtet në thelb rrjedhin prej formash latine, porse janë formime të brendshme të shqipes të dala prej sosh. Kështu p.sh. te *dëllír* nuk do të kërkojmë, me Gustav Meyerin, një lat. \**deliberare*, po - pjesërisht pas hullisë së H. Peder-

senit<sup>97</sup> — një formim me *dë-* të fjalës *lirë*, kjo vetë pas gjase prej lat. *liber* «i lirë». Duke zbatuar më tej këtë parim, vihet re se edhe fjalë të tilla si *dëshir*, *dhuratë*, *dhuntí* *dhurëtil'ë* «dhuratë», *femuar* «për një që është si grua, pa burrëri», *fishnjár* *fushnjár* «vegël peshkimi në trajtë shtize», *kunatë*, *kunatóll* «kunat», *kundërshtár*, *kungatë* «buka (nafora) dhe vera e bekuar me të cilën kungohen të krishterët në të kreme të caktuara të vitit», *martesë*, *mblatuer* *latëtuar* «formë e drunjte me të cilën vulosin bukët e meshës», *pendull* «pendë», *puliz* «morr pulash», *urdhëratë* «njeri që mund të urdhërohet për ndonjë shërbim shtëpiak», *verdhaq*, nuk reflektojnë ndonjë lat. *desiderium*, *donatum*, *\*donatilia*, *\*feminorius*, *\*fusciniarium*, *cognata*, *\*cognateolus*, *\*contrastarius*, *communicatum*, *\*maritatio*, *\*oblatitorium*, *\*pinnula*, *\*pullina*, *ordinatum*, *\*viridaceus*, po paraqesin përkundrazi përkatësisht formime retrograde ose rrjedhoja të fjalëve *dëshirój*, *dhurój*, *femër*, *fushnje*, *kunát*, *kundërshtój*, *kungój*, *martój*, *mblatë*, *pendë*, *pulë*, *urdhër*, *verdhtë*, të cilat rrjedhin prej lat. *desiderare*, *donare*, *femina*, *fuscina*, *cognatus*, *contra*, *communicare*, *maritare*, *oblata*, *penna pinna*, *pulla*, *ordinem*, *viridis*. Ashtu qëndron puna edhe me foljet *dëmój*, *dëmtój*, *dëtój* «i detyroj dikujt, jam detorës», *gëzój*, *lirój*, *shtrenjtój* *shtrencój*, *urdhëroj*; edhe këto nuk janë vazhdimë të lat. *damnare*, *\*damnitare*, *\*debitare*, *\*gaudire*, *liberare*, *\*strinctiare*, *ordinare*, po janë folje prejemërore (denominative) të *dëm*, *detorës*, *gaz*, *lirë*, *shtrenjtë*, *urdhër*, këto vetë prej lat. *damnum*, *debitorem*, *gaudium*, *liber*, *strinctus*, *ordinem*. Ashtu edhe *lëftój* *luftój* më fort është rrjedhoja foljore e *luftës-s* sesa lat. *luctari*<sup>98</sup>, dhe *zbulój* nuk është ndonjë lat. *\*disvelare*, po asgjë tjetër veçse opoziti i *mbulój*. Format *fije* edhe *koqe* nuk janë reflekse bazash latine *\*filia* edhe *\*cocceum*, që nuk dalin të dëshmuara gjëkund, po janë shumëset e singularizuara të fjalëve *fill* edhe *kok*, këto vetë prej lat. *filum* edhe *coccum*<sup>99</sup>. Për mbiemrin *i kaltër* prej lat. *caltha*, që u zu ngoje më sipër, nuk duhet të ndërtojme një bazë latine *\*calthinus*, sepse *-ër* (*-ën*) është një zgjerim sufiksial i brendshëm i shqipës, sikundër e tregojnë edhe trajtat *i kalë*, *i kaltë*, *i kaltën* që jep *Gazulli*. Një formim i brendshëm i gjuhës është edhe *keshjëjt* *kalçind* «potir i meshës», i cili nuk pasqyron ndonjë lat. *calix sanctus*, që nuk jeton gjëkund, po s'është veçse *kelq shenjt*. Nga fusha e rumanishtes me këto trajta mund të krahasohen rasta të tilla si *berbecar* «bari dhensh, delmer», *grăuncior* «kokrrizë», *înspina* «me therë me një gjemb», *lemnar* «zdrukhtar; tregtar lëndësh të drurit», *pielar* «gëzoftar», *portar* «derëtar», *rămășiță* «mbeturina». Këto fjalë tani me të drejtë merren më fort si formime të brendshme të rumanishtes, si *berbec-ar*, *grăunț-ior*, *în-spina*, *lemn-ar*, *piel-ar*, *poartă-ar*, *rămăș-ită*<sup>100</sup> sesa — si më parë — si reflekse bazash latine *\*berbecarius*, *\*granúnciolum*, *\*(in)spinare*, *lignarius*, *pellarius*, *portarius*, *\*rema(n)sicia*. Gjithashtu edhe përemrat *neșcare* «dikush, dicili», *neștine* «dikush», *neșcit* «dishka, pak» të rumanishtes janë më

97) KZ 33, 538.

98) Kështu tani edhe W. Cimochoowski, *Lingua Posnaniensis* VIII 138.99) Jokl *IF* 36, 159, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 130. Autori në *Lingua Posnaniensis* VII 150, 155, VIII 95, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 16, 21v., 112, 161.100) Khs. A. Graur në *Bulletin Linguistique* V 87, 110; M. Sala në *Revue de linguistique* 1 (1956) 147 v.; *Dicționarul limbii romine moderne* (1958) sub vocibus.

fort «shkurtime të brendshme» të *neștiucare* «nuk di cili», *neștiucine* «nuk di se kush», *nuștiucit* «nuk di sa» sesa lat. *nescio-qualis*, *nescio-quem*, *nescio-quantum*. — Produktiviteti, pjelloria e sufiksit që hyri në gjuhë me anë formash si *factūra*: *fytyrë*, *natūra*: *natyrë* etj., sqaron edhe formimin e disa fjalëve si *detyrë* pranë *detorës*-it që vjen prej lat. *debitorem*, *shembëlltyrë* «figurë, fytyrë, parabull» prej lat. *similare*, *shërbëtyrë* «shërbim, punë» pranë *shërbëtór* prej lat. *servitorem*, *pagëtyrë* «shpërbim, pagë» prej it. *pagare*; forma këto, për të cilat prandaj nuk është më nevoja të ndërtohen baza si \**debitūra*, \**similatūra*, \**servitūra*, *pagatūra*.

Një tjetër grup e përbëjnë disa fjalë që kanë pësuar një shndërrim nëpërmjet ndikesës së ushtruar nga ana e disa fjalëve të tjera e me burim vendi. Aty hyn *gjymtyrë* prej *iunctūra*, duke iu mbështetur fjalëve *gjymt* «i sakatuar, i gjymtuar» *gjymtój* «e pakësoj, i heq një pjesë; e lë sakat»<sup>101</sup>.

Në lidhje me këto rasa meritojnë vëmendje dhe disa të tjera, për të cilat shpjegimi latin i gjertanishmi nuk qëndron, po është i zëvendësueshëm me një tjetër, edhe ky me mjete të gjuhës latine. Kështu p.sh. lat. *computare* «me llogaritë, me numëru» nuk përmbahet te *kuptój*, po te *kumtój* «lajmoj», fjalë që ka mbetur e pavënë re gjër sot, ku ndërkaq do një sqarim afria që ka me *kumt* «lajm» në lidhje me lat. *computus* «llogari», khs. dhe rum. *cumpāt* «qëndrim i matur, gjykim». Ashtu dhe lat. *glandula* «gjëndër» nuk rron te fjala *lende*, po te *gjëndër*, e cila u përmend dhe më lart; edhe lat. *tradere* «trathtoj» nuk gjellin te *tregój*, po te *truaj* «ia kushtoj», *truej* «nëm, mallkoj». Duke qenë i drejtë barazimi lat. \**marrucinea marrucina*: shq. *mërqinjë* «ferrëkuqe, drizë» rum. *mārācine mārācine* «ferrë», nuk ka si të rrjedhë po prej asaj gurre latine fjala *murriz morriz*, e cila është e formuar krejt ndryshe. Edhe *fëlliq* nuk ka si të jetë vazhdimi i lat. *fornix fornicem*, sa kohë që kjo reflektohet me *furëqi* «fornicatio, luxuria, kurvëri», e cila u zu ngoje më lart, f. 26. Ashtu dhe lat. *indulgeo* nuk mund të jetë gurra e përbashkët edhe e *ndjej ndëjéj* «i fal fajin» edhe e *përdëlléj* mëshiroj; shkoj për kryeshëndoshë», sepse kjo e dyta vjen prej *për* — + lat. *dolere*, sh. më lart f. 19. Të *ndërtój dërtój* nuk përmbahet ndonjë \**directare*, e cila nuk shfaqet gjëkund në gjuhët romane, po përmbahet përkundrazi *tractare*, si vazhdim i së cilës gjer sot kanë njohur vetëm *trajtój*. Për *urój* dihet prej kohësh që bashkë me rum. *ura* «uroj» rrjedh prej lat. *orare* «li-gjëroj, lutem, falem», jo prej *agurare* «uroj». Për fjalën *kafshë* «shtazë barre, kalë, mushkë a gomar; shtazë përgjithësisht; gjë, send» duhet të kthehemi tek etimologjia e parë e Gustav Meyerit, te lat. *causa*, e të heqim dorë nga e dyta e tij, nga *capsa* «arkë», me gjithë se është pranuar prej shumëkuj, khs. për kuptimin e *kafshë-s* it. *cosa*, frgj. *chose*, irl. e vj. *cois* irl. e re *cuis*, të gjitha me kuptimin «gjë, send»; *duq* «lëfyti i drunj-të i fuçisë, kanjelë», për arsye fonetike është më fort lat. *dux ducem* f.

101) Ndryshe G. Reichenkroni, në *Romanistisches Jahrbuch* IX 87, 110 shën 17: *gjymtyrë* prej lat. *iunctura*, nëpërmes të një trajte \**gjymtyrë*, me anë të një kalimi parahistorik të *n-së* në *m* përpara një *t-je* në rumanishten e në shqipen, rum. *simf* «ndiej» nga lat. *sentio*. Një ndrim fonetik i tillë nuk shihet të dalë kund në gjuhën shqipe.

«krua, çesme» (khs. veljot. e Dalmacisë *dauk*, logudor. e Sardenjës *tuge* «shtupë druri e mbuluar me peca, që mbuton fuçinë») sesa *ductum* «vijë, përçues». Ashtu edhe *gatë* «Ardea cinerea, çafkë» më fort është lat. *catta* «shpend si delikatesë», deminutivi *cattula* «Tetrao bonasia», sesa *ganta* «patë e egër», *parmendë* më fort lat. *paramentum*, e cila rron në gjuhët romane me përdorimin «stoli», sesa një \**peraramentum*, që nuk dësh-mohet gjekundi. Fjala *gjyq*, e cila tek autorët e vjetër të Veriut është përdorur si asnjanes, më fort është lat. *iudicium* «gjykim, gjyq» se *iudicem* «gjyqtar». Për *taftar* e për *koqe* sh. më sipër.

Duke rrokur me një vështrim ç'u shtjellua gjer këtu, besojmë se do të pranohet që në lëndën leksikore të shqipes me burim latin do të bëhen shumë më tepër zbritje se shtesa. Pamja e kësaj lënde ndërkaq nuk do të delte e plotë, prandaj edhe jo objektive sa duhet, po të mos merreshin parasysh, krahas me zbritjet, edhe ato shtesa në masën që meritojnë. Këtu pikësëpari duhet thënë se për disa fjalë burimi latin ka dalë i drejtë, në kundërshtim me shpjegimet e tjera që kanë qenë dhënë për to. Një fjalë e tillë është *perëndi*, për të cilën kuptimi «të qenët zot; zotëri, zotërim, sundim», që është i vetmi që del në literaturën më të vjetër, e bën të besueshëm rrjedhimin prej lat. *imperantem* + *i*, që kanë dhënë Franz Boppi (f. 515 shën. 1, f. 520 shën. 1) me Gustav Meyerin. Ashtu qëndron puna edhe me *bulë* «sythi i bimës a i pemës, mullull nga i cili del bisku a lulja», me *fat* «i shoqi, burri», me *ftujë* «keçe motake», me *këndellem knellem* «kuqem; ndizem, marr zjarr, digjem; përtërihem, marr fuqi, çelitem», me *martó*, në lidhje me lat. *bulla* «fshikëz uji; sumbull, pullë», *fatum*, \**vitulea*, *këndellë* nga lat. *candela*, e *maritare*. Një pasurim të mëtejme paraqesin huazimet që kanë dalë në shesh në kohën pas Gustav Meyerit, ose që u vunë re në këtë kohë, kryesisht nga ana e Norbert Joklit, si *fënër fner* «hinkë, taftar» prej \**fundarium*, *fojletë* «Celtis australis, carac» prej (arbor) *foliata*, *i komtë* «nga qime kali» prej *coma* «flokë, jele; gjethe drurësh» (ku hyn edhe *komë* «jele e kalit», *komez* «krimba që shpiken në zorrët e deleve», *kómëtë* «një tjerë me lesh dhie»<sup>102</sup>), *mahajër* «djerrinë» prej (dalm.) \**maiarium*, *mbroj e përónj* prej *parare*, *mëgashtër* «sherbelë» prej \**medicaster*, *nosh-tër* «bimë» prej \**nóvaster*, *pashtrák* «vendi i kullotës brenda kufive të një bajraku; gjobë për shpërdorim të kullotës së huaj» prej \**pasturaticum*<sup>103</sup>, *rretër* «gjalmë e gjatë e dredhur, sidomos prej lëkure; dredhë e lëkurtë e opingës» prej \**retina* «fre», *rjesht* «rresht, radhë, rend» prej *restis* «litar, tërkuzë, konop», *shqeme sheme* «luzmë e bletës» prej *examen*, *timën timër* «filli për së gjati i pëlhurës, maja» prej *tegmen* \**temen* «majë e pëlhurës» me kuptimin e *subtegmen* «ind» (M. L. Wagner), *tratk* «tatim për marrje të një sendi me qira» prej \**terraticum*, *vitërk* «njerku» prej *vitricus* (C. Tagliavini), *zmojle* «djerr, qersë» prej \**exmulgia*. Nga

102) *Lingua Posnaniensis* VIII 108, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 129.

103) Për sufiks-in *-aticum* të latinishtes së vonë, veçanërisht edhe të latinishtes ballkanike, përveç *agraticum* që përmend Jokli e që ka qenë e gjallë në Kotor, khs. edhe *ἀρβατικόν* nga \**herbaticum* «e drejta e barit ose e drejta për të kullotur bagëtinë, te M. Triandafylidis, *Die Lehnwörter der mittelgriechischen Vulgärliteratur* 128.

këto latinizma, disa, si \**fundarium*, \**maiarium*, \**medicaster*, \**nóvaster*, i ka vetëm gjuha shqipe, prandaj ato hyjnë në grupin e formave që u përmenden më lart, f. 19v. Disa të tjera, si *avlëmënd*, *çimkë*, *dullye*, *furëqi*, *gazmënd*, *i kaltër*, *kanushë*, *kubël*, *kumt*, *kumtój*, *tallë*, *trujaj*, edhe këto u zunë ngoje më sipër. Në latinizmat e pavëna re gjer më sot hyjnë edhe *kanurkëz* «boshti me perin e leshit që shkon e vjen si meqik, kur punojnë shajakët në tezgjah» prej *conucla* «*furkë*», *marcél mercél melcér* «paftë e verdhë në trajtë të një floriri, që varin gratë për stoli», me sa duket, prej *margella* «*koral*», (serbokr. *medela* «*koral*», rum. *mârgea* «*koral*, *merxhan*»), *mergjúr* «të hollat që paguante dhëndri për nusen e që ajo i përdorte zakonisht për të bërë pajën» prej *merx mercem*, *nofull*, prej *offula* (*n-ofull*), *rrobull* «pishë mali» (nga *robur*), e cila ka hyrë dhe në aromnishten (*arobul* «bredh i bardhë»)104, e më në fund *vigjéz* «*Vicia*, *grashinë*» prej *vicia*. Një zhvillim kuptimor interesant ka kryer fjala *teshë* «gjë, plaçkë; ashkël që del në sy» shm. *tesha* «plaçka shtëpie, rroba; petka», e cila pas mendimit tim rrjedh nga *testa* «*guaskë*, *garraç*, *rrashtë*, *kokë*»; khs., për kuptimin, *enë*, në shqipen e Atikës «*petka*, *shtresa* e *mbulesa*». Një visar i vërtetë janë emrat e përveçëm, sidomos emrat e viseve. Mbetet një ndër meritat e Norbert Joklit, që emra si *Groftat* prej lat. *crypta crypta* «*zgafile*, *shpellë*», *Pëdhanë* prej *pedanea* «që i përket këmbës» (:«që gjindet në rrëzë të malit»), *Rrjoll* prej *rivulus* «*prroskë*», *Sift* prej *exsuctus* «i thatë», *Shkortull* prej *curtus* «i shkurtër», *Shutrija* prej *subterraneum* «i nëndheshëm», ka tërhequr vëmendjen edhe mbi këto burime të gjuhës105. Këtyre do t'u shtohen tani edhe *Frákulla*, emri i një katundi që gjindet në afërsi të disa rrenojave antike, ku H. Ceka vuri re se përmbahet lat. *Oraculum*106, pastaj *Vinjáll* në Mat, pas gjase prej *vinealis* (*terra*), *Kurbí* në Veri prej *Corvinus*, e ndonjë tjetër. Njohja e metë e visarit të fjalëve të shqipes ka shkaktuar që edhe elementet latine të sajat nuk janë bërë të njohura në masë të plotë. Kjo rrethanë ndërkaq lë njëkohësisht të shpresohet që me një hulumtim më të mirë të dialekteve, ndër elementet gjer sot të paditura të leksikut të dalin në shesh edhe huazime të tjera me gurrë latine. Elementi latin i shqipes në të kaluarën është e sigurtë se ka qenë më i plotë se sot, dhe se me pakësimin e përgjithshëm të leksikut të lashtë ka shkuar hap më hap edhe një pakësim i këtij elementi. Me traditën shkrimore të shqipes, që është njëja e vonë, nuk është e mundur të ndiqet ky proces me hollësi për shekujt e mëparmë. Për perioidën letrare, nëpërmjet përmendoreve të shkrimit vërehet një pasuri më e madhe huazimesh latine, huazime më fort gjysmëlibrore (gjysmësavante), e kryesisht të sferës kishtarë. Ky burim plotësohet mirëfilli pjesërisht me anën e dialekteve të gjalla sot, e pjesërisht me anë të dokumenteve mesjetare. Nga këto tani vijnë në vështirë sidomos dokumentet i që gjinden nëpër arkivat shtetërore osmane, të cilat nganjëherë vijnë e i zditrin dëshmitë letrare në mënyrë të prerë e të padyshimtë. Kështu tani për emrin e vjetër të një mase, *kartë* (shkruar *carte*) «*masë drithi*», që gjindet te Gj. Buzuku (për

104) T. Papahagi *Etimologii* 5, *Dicționarul dialectului aromin* 124.

105) *Balkan-Archiv* IV 202v., *Zeitschrift für Ortsnamenforschung* X 196v., *Revue Internationale des Etudes Balkaniques* II 58 v., 70 v.

106) *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkenca Shoqërore* 1 (1957) 24 shën. 14.

lat. «corus»<sup>107</sup>, sigurohet kjo mënyrë leximi mbi dëshminë e masës *kartë* «30 vukije, ose 30 okë», afërsisht 38.460 kilogram<sup>108</sup>, e me këtë mbetet jashtë çdo dyshimi burimi i fjalës prej lat. *quarta, quartus* «çerek». Fakti që *χάρτη* «kuart litri» gjindet dhe në greqishten e mesme (te Triandafylidis, f. 125) tregon se kemi të bëjmë me një huazim prej latinishtes ballkanike. Greqishtja me shqipen kanë edhe një tjetër emër mase po të atij burimi, e ky është *μόδιος, μόδι*, shq. *muz (moz)*, prej lat. *modius* «shinik». Kjo fjalë sot në shqipen ka humbur, po dëshmohet po tek ai dokument osman si një masë dyfishi i një karte, pra si një barrë gruri, 60 okë. Grafia turke *مو*, nga puna e vlerës fonetike dyfishë të vav-it, lë të mundur dy lexime (*muz* edhe *moz*), veçse mbi dëshminë e fjalës *shpuzë* «hi i nxehtë, i përzier me prushe të vogla» nga lat. *spodium*, ndër ato dy lexime do të parapëlqehet i pari. Desha të tërheq vëmendjen mbi këtë, që gr. *μόδιον, μόδι* dëshmon për ekzistencën e trajtave më o në latinishten ballkanike, në disa rase që në shqipen e në rumanishten paraqiten me u, si *spodium*: shq. *shpuzë* rum. *spuză, ordinem*: *urdhër urdin*. Prandaj nuk shkon që — pas hullisë së I. Şiadbeit<sup>109</sup> për këto trajta të postulosh, të vësh kusht një burim prej latinishtes ballkanike dhe të mohosh mundësinë e një zhvillimi fonetik të brendshëm të shqipes e të rumanishtes në këtë pikë, ose të një huazimi të ndërsjelltë (reciprok) midis dy gjuhëve të fjalë.

Duke përmbledhur ato që u shtjelluan këtu, arrihet në përfundimin që elementi latin, si për vjetërsinë si për përmasat e tij, si edhe për rëndësinë kulturore që ka, zë një vend kryesor ndër elementet me burim të huaj të shqipes. Ndonëse është pak më i vonë se elementi me rrjedhë prej greqishtes së vjetër, për punë të pasurisë së tij mbetet më i rëndësishëm se ai. I vështuar në tërësinë e tij, ky ndikim do të shikohet jo si depërtimi i një sistemi gjuhësor në një tjetër, porse si një përkthim intensiv i leksikut, ku ka dhënë më fort emra, mbiemra e folje, po sporadikisht edhe ndonjë parafjalë, pastaj si një ndikesë në fjalëformim, me anë të disa sufikseve. Duke u përkshuar nëpër zhvillimin dymijëvjeçar të shqipes gjer në ditë të sotme, po duke ruajtur njëkohësisht edhe formën fonetike të vetën, huazimet latine kanë arritur të bëhen një udhë-tregues i besueshëm në punë të kronologjisë së ndërrimeve fonetike të vjetra të shqipes, dhe me këtë kanë marrë një rëndësi të madhe për historinë e brendshme të gjuhës. Që ato janë me rëndësi edhe për historinë e romanizimit në gjuhët fqinje me shqipen, edhe kjo mendojmë se ka dalë nga shtjellimet më sipër. Kësaj fushe studimesh dija iu ka afruar gjer më sot pjesërisht nga ana e gjuhëve romane, pjesërisht nga ana e rumanishtes, pjesërisht nga ana e sllavishtes jugore-dalmatishtes, e pjesërisht nga ana ballkanike në përgjithësi. Po mundet që të hapen perspektiva të reja e të arrihen dhe rezultate të reja, po të merren e të shikohen këto sende edhe nga pikëpamja e gjuhës shqipe. Gjuhësisë në çdo rasë i del përpara detyra që pas një periode gati njëqindvjeçare gjurmimesh në këtë fushë, të mbërijë në një sintezë të çështjeve dhe të re-

107) *Njëqind kartë grunë* «centum coros tritici», LXXV/2, = LXXXV/2, Luka 16, 7.

108) Te Omer Lutfi Barkan, *Kanunlar* (1945) 291.

109) *Mélanges linguistiques publiés à l'occasion du VIII<sup>e</sup> Congrès International des Linguistes à Oslo, du 5 au 9 août 1957*, Bukuresht 1957, f. 66.

zultateve. Mbi të gjitha shtrohet detyra që me një shoshitje të re të materialit dhe me një interpretim të gjendjes gjuhësore nëpërmjet historisë, të arrihet në një rregull e një qartësi më të madhe në rindërtim të latinitetit ballkanik, shtrohet detyra që të veçohen e të dallohen mirë format bazë të fjalëve të periodës antike nga zhvillimet e mëvona të gjuhëve të veçanta. Si punë e mëtejme vjen pastaj detyra që të arrihet në një pamje historikisht më të drejtë të romanitetit lindor me përmasat e tij dhe me kufitë e caqet që i takojnë.

### Résumé

#### CARACTERES GENERAUX DES EMPRUNTS LATINS DE L'ALBANAIS<sup>1</sup>

Les emprunts latins de l'albanais, importants tout aussi bien pour les études latines et romanes que pour l'albanistique elle-même, sont à examiner dans le cadre territorial et historique où s'est exercée l'influence du latin sur l'albanais. Du point de vue géographique cette influence a eu lieu en général dans l'espace où se parle actuellement l'albanais. Sa durée embrasse au moins sept siècles, dès avant les guerres illyriennes de Rome jusqu'après l'arrivée des Slaves dans ces parages.

Il est aisé de concevoir que dans un si grand laps de temps les mêmes phonèmes latins ne soient pas toujours reflétés de la même manière en albanais, mais qu'il y ait des différences d'ordre chronologique. Des divers avis émis à ce propos par des savants tels que G. Meyer, R. Helbig, S. Puşcariu, N. Jokl, H. Barić, est à retenir notamment celui de G. Meyer, à savoir que le maintien du caractère guttural du *c* latin devant un *e* ou *i* indique une pénétration du latin en albanais en une période de l'antiquité assez reculée. La même chose est attestée, au domaine du lexique, par le reflet du lat. *cepa* face à celui de *cepulla*, continué dans la plupart des langues romanes.

La position de l'élément latin de l'albanais est caractérisée d'une part par le fait qu'il fait partie — avec le roumain, le dalmate et l'élément latin du serbo-croate et du néo-grec — de la romanité orientale, dérivant du latin dit balkanique, d'autre part par les concordances qu'il présente avec diverses branches de la romanité occidentale. Cet élément tient ainsi une position centrale, en formant un certain lien entre les deux sphères du monde roman.

En entrant dans les détails de cet ordre d'idées, on doit noter que dans le cadre de la latinité balkanique l'élément latin de l'albanais se rapproche le plus, comme on le sait, du roumain, bien que, dans l'état actuel des recherches, il faut faire des réductions quant aux équations de prétendue origine latine dans les deux langues. Les supposées analogies phonétiques entre l'albanais et le dalmate sont bien douteuses; il subsiste pourtant des concordances d'ordre lexical, à déduire surtout des restes du dalmate survivant dans les parlers serbo-croates. Il est digne de relief que dans ce cadre l'albanais se distingue par la présence de certains termes du langage ecclésiastique qui manquent aux langues voisines. Des autres idiomes romans, on sait que notamment les parlers de l'Italie méridionale se rapprochent dans certains aspects de leur système de l'élément latin de l'albanais et du roumain. Non moins caractéristiques sont, d'autre part, certaines concordances lexicales de provenance latine que présente l'albanais avec le rhéto-roman d'une part, le sarde et l'ibéro-roman de l'autre, avec ces dernières branches souvent en commun avec le roumain. On doit cependant faire remar-

1. Revue de linguistique, t. VII, 1962, Nr. 1, pp. 161-199.

quer que non toutes les concordances spéciales sont pertinentes pour déterminer la place de l'élément latin de l'albanais dans l'ensemble des langues romanes, et que cette langue contient, d'autre part, une masse considérable d'emprunts latins, d'un caractère roman général.

L'une des tâches principales aux fins d'une caractérisation des éléments latins de l'albanais consiste en leur distinction d'une part de l'élément hérité de la langue, d'autre part de ses autres emprunts, pour arriver à délimiter ce qui est latin d'avec ce qui n'est pas.

A ce propos, pour la dernière période de l'action du latin, il s'agit de discerner les emprunts latins de ceux italiens, tâche pas toujours aisée à réaliser. Un critère général consiste ici dans le fait que les emprunts latins, en raison de leur âge, ont subi, au cours des temps, des changements phonétiques plus profonds que les emprunts italiens. Un certain nombre de mots ont pénétré, en outre, dans deux étapes successives, et, par conséquent, sous deux formes différentes, latine et italienne. Une attention spéciale méritent ici les latinismes savants à côté des emprunts populaires, en outre les mots empruntés au latin médiéval, une catégorie passée presque inaperçue jusqu'ici, et d'autre part, dans le domaine des emprunts faits à l'italien, les vénétianismes proprement dits face aux autres italianismes.

Par rapport aux autres langues romanes, une action exercée par le dalmate, jusqu'à nouvel ordre reste douteuse. En ce qui concerne le roumain, on doit encore séparer les emprunts dus à cette langue (ou bien au dialecte aroumain) de ceux remontant directement au latin. Une tâche analogue à celle-ci consiste à examiner la question d'une médiation albanaise dans certains éléments latins du roumain. Aux mots latins communs à ces deux langues il y a lieu d'ajouter maintenant tel élément nouveau, pas remarqué jusqu'à présent, comme alb. *shelqërór shelqruer* «bois fourchu, à trois ou quatre crochets, fixé devant la cabane du berger, qui sert à pendre ses ustensils»: roum. *sârciner sâlciner* même sens, lat. *sarcinarius*, de *sarcina* «paquet, bagage», où fait part encore l'italien de Calabre *sarcinaru* «grossa trave del tetto, trave maestra».

Difficile souvent, dans quelque cas même problématique, reste à maints égards le discernement des éléments latins de ceux qui remontent au grec ancien. Sans entrer ici non plus dans les détails, on notera qu'il faut distinguer notamment deux groupes divers: mots grecs pénétrés en albanais par voie directe, ou à travers le latin, et — inversement — emprunts latins directs, ou bien transmis par la voie du grec (moyen ou moderne). La solution est facilitée dans de tels cas par l'accent, et précisément par le maintien de sa place dans le mot en albanais. De cette manière, *qershí* «cerise» p. ex. revient au gr. *κερασία*, *qjerpën* «melon» à *πέπων* (non pas aux lat. *cerasum*, *peponem* qui en dérivent); *balladër* «cascade, chute d'eau» et *kulshedër* «dragon» par contre ne remontent pas du tout aux gr. *βάραθρον* et *χέρσυδρος*, mais plutôt à leurs reflets latins *barâthrum* et *chersýdrus*. Pour certains mots on doit tenir compte d'une plus ancienne couche méditerranéenne comme troisième source possible. Un groupe à soi embrasse des éléments latins pénétrés en albanais à travers le slave balkanique, un autre des éléments rentrés par la voie du turc. Bien plus considérable est enfin la masse des mots regardés jadis — et, pour une part, même à présent — comme étant d'origine latine, et qui résultent appartenir au fond hérité propre de la langue.

En recherchant l'influence latine dans les divers aspects de la structure linguistique de l'albanais, on n'aperçoit tout d'abord aucune action sur son système phonétique. Des reflets différents qui comme tels font problème, sont à mentionner notamment *ve-* et *vo-* *va-* provenant d'un *o* latin initial (*opera*: *vepër*, *orphanus*: *i vorfën i varfër*), *o* et *u* d'un *o* court bref (*corvus*: *korb*, *ordinem*: *urdhër*, comme

en roumain), *e* et *u* d'un *o* long (*pōmum*: *pemë*, *canōsa canōsus*: *kanushë* «cigogne»), *a* et *av*, *af* provenant de *au* (*aurum*; *ār*, *laudem*: *lavd*, *causa*: *kafshë*), *e* et *i* d'un *e* bref (*mend* «esprit, raison», mais gjind «gens», *prind* «parents», *qind* «cent», comme en roumain), *nj* et *ng* (*signum*: *shenj* et *sheng*), *j l* et *l vélaire* (II) d'un *lj* (*famīlia*: *fēmijë fēmilë*, *consilium*: *këshill*, *evangelium*: *ungjill*), où on adjoindra encore la métaphonie *a:e*, type *imperator*: *mbret*. La position de l'accent dans le mot est maintenue, comme l'a remarqué P. Skok, d'une manière régulière. Avec H. Pedersen on conviendra que l'action du latin n'a pas touché le système des formes grammaticales, la terminaison verbale *-oj* nê reflétant lat. *-are*, ni l'aoriste type *këndova* lat. *cantabam* it. *cantavo*, ni l'optatif *këndofsha* lat. *cantavissem*, ni le pronom *kuj* «à qui» lat. *cuius*. A excepter, à notre avis, le parfait du type *kam shkruar* «j'ai écrit», roum. *am văzut*, gr. moderne ἔχω δεῖμένο, où on trouvera, avec M. B. Havránek, l'influence du roman balkanique, cependant plutôt dans le sens d'un calque linguistique d'ordre grammatical. Du système nominal, à relever surtout le maintien fidèle du genre, soit à propos du neutre (*damnum*: *damtë*, etc.), soit à propos des féminins de l'ainsi dite troisième déclinaison latine, type *gentem*: *gjind gjindja*, qui se sont rangés à une catégorie du système hérité, du type *et etja* «soif». L'action du latin a atteint aussi la formation des mots, surtout à travers quelques suffixes, qui semblent pourtant avoir trouvé souvent des formes analogues dans le patrimoine même de l'albanais.

En ce qui concerne enfin le lexique, dans l'état actuel des études on convient que l'influence latine a été surestimée. Des prétendus éléments latins sont à éliminer plus de 250 mots, dont la liste a été donnée en partie dans le texte. Il y a bon nombre d'autres mots dont l'origine latine est douteuse. Un groupe à soi est formé par des mots qui remontent, en dernière analyse, à des formes latines, mais seulement par voie indirecte, étant des formations internes de la langue. Ainsi donc, *dëshir* «désir» n'est pas lat. *desiderium*, mais une forme rétrograde de *dëshirōj* «désirer» provenant à son tour du lat. *desiderare*; de même, *detyrë* «devoir, dette» n'est pas un lat. \**debitūra* nulle part attesté, mais une formation de *dëtorës* «débiteur», de lat. *debitōrem*, etc. Tout aussi, roum. *neșcare* «quelqu'un» ne reflète pas du tout lat. *nescio-qualis*, n'étant qu'une lexicalisation de roum. *ne știu care* «je ne sais pas qui». Une autre catégorie est formée par des mots dont l'origine latine est assurée, mais doit être rattachée à une autre base de cette langue. Ainsi p. ex. *gjyq* «tribunal, procès, jugement» remonte à *iudicium*, non point à *iudicem*; et lat. *tradere* n'a pas donné *tregōj* «montrer, indiquer», mot du fond hérité, mais plutôt *truaj truej* «dédier; blâmer».

Il faut relever, d'autre part, que l'albanais a conservé des éléments latins en partie passés inaperçus jusqu'à présent, dont quelques-uns survivent seulement en cette langue, en présentant comme tels un intérêt scientifique particulier. A N. Jokl revient le mérite d'avoir attiré l'attention aussi sur les vestiges latins dans la toponymie albanaise. D'autres traces se retrouvent dans des anciens documents historiques, notamment dans ceux de provenance osmane.

Comme on le voit, les éléments latins sont d'une grande importance pour l'étude de l'albanais et de son histoire, dont ils ont parcouru l'évolution bimillénaire. Ils sont d'importance tout aussi pour l'histoire du latin même, et spécialement pour celle des langues romanes des pays balkaniques. L'une des tâches à venir en ce champ d'études consistera à mieux préciser les dimensions du domaine désigné par le nom de romanité orientale.